

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 194, Dhjetor 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Të dashur dukagjinas e dukagjinase e dashamirës të Dukagjinit. Muaji dhjetor shënon kështu edhe mbylljen e vitit 2019. Ndërsa përgatitemi për mbylljen e tij, mendojmë njëkohësisht që sapo kaluam tërmetin e 26 nëntorit, i cili shkaktoi një traumë kolektive tek të gjithë ne për shkak se la pas zona të tëra me rrënoja, humbën jetën fëmijë, të rinj e të reja e të tjerë, la familjarë që janë ende në rrugë, pa shtëpi, pa strehë, të cilët do ta kalojnë këtë festë nëpër bujtina/hotele apo nëpër familje të tjera mikpritëse. Nisur nga përjetimet tona të dhimbshme në këto ditë të vështira dhe të inkurajuar nga ndjesia humane e të gjithë shqiptarëve por jo vetëm, kemi menduar si redaksi që të bashkëndajmë me ju kartolinën dashamirëse "Të bashkëndajmë pemën e Krishtlindjes". Le të ndërtojmë një Betlehem e krahas tij edhe pemën e Krishtlindjes duke përforsuar shenjën e solidaritetit dhe besimit për të ardhmen e të gjithëve. Pikërisht sepse Betlehemi i këtij viti është i veçantë. Përveç të tjerave, është një thirrje e fortë për të na mësuar alfabetin e vetëdijshëm emotiv që bashkon shkronjat në ndërtimin e fjalëve të tilla si: vëmendje, kujdes dhe dashuri për tjetrin. Le të reflektojmë thellë dhe të vihemi në veprim. Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2020.

REDAKSIA

88-VITE ARSIM NË HOT TË RI



Me rastin e 88-vjetorit të arsimit në Hot të Ri dhe 20 vjetorit të ndërtimit të shkollës së re "Dedë Gjon Luli" u organizua një veprimtari muziko-letrar nga grupi artistik i shkollës, në të cilën ishin të ftuar, prindër, ish mësues-ish nxënës dhe ish drejtues të kësaj shkolle. E ndërruan me pjesëmarrjen e tyre këtë veprimtari Shoqata "Martin Dreshaj" nga Peja, [znj. Valbona Tula] drejtoresh për Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (ish mësuese në këtë shkollë), Sindikata e Arsimit të Kosovës...

“RRITJA PAS TRAUMATIKE” MUNDËSIA E PËRMIRËSIMIT TË VETVETES DHE E SHNDËRRIMIT TË ASPEKTEVE NEGATIVE TË JETËS NË NJË BURIM TË TRANSFORMIMIT POZITIV KOLEKTIV

Tërmeti i 26 Nëntorit tronditi mbarë shoqërinë shqiptare e cila u zgjua në mëngjes me panic dhe me ndjesinë për ta kthyer atë në një gënjeshtër. Në mbrojtje të një realiteti, qënia njerëzore është në gjendje të sajojë tipe të ndryshme gënjestrash për të mos lënduar të tjerët si psh gënjeshtira të bardha, gënjeshtira blu, gënjeshtira kompulsive dhe gënjeshtira patologjike. Më konkretisht çfarë ndodhi me ne në orët e para të mëngjesit të 26 nëntorit?

Nderohen me vlerësimet më të larta humane nga MISIONI DIPLOMATIK PËR PAQE E PROSPERITET I AKREDITUAR NË TIRANË, malsorët Shtjefen dhe Gjyste Ivezaj

E nisa këtë shkrim me këtë porosi të veçantë të Nënë Terezës, Nobelistes së Paqes & Shenjtores së Kalkutës e cila ka zënë vend më së miri në këtë mision tejet të veçantë në vlerësimin malsorëve, Shtjefen dhe Gjyste Ivezaj, pasi serioziteti dhe vlerësimi i tyre u bë falë hulumtimit dhe ndjekjes nga afër të veprimtarisë së këtyre malësoreve z. Ndue Dodaj, Misionar i Paqes & Anëtare Nderi i këtij misioni diplomatik si dhe pjesë e stafit të punës e veprimtarive që zhvillon ky mision në bashkëpunim me partnerët e vet ndërkombëtar, kudo në trojet etnike.



VËSHTRIM

KRITIK MBI

VEPRËN E

GJEÇOVIT

“KANUNI I LEK DUKAGJINIT”

Për veprën e Gjeçovit janë mbajtur shumë simpoziume dhe takime qysh nga vdekja tragjike e tij në vitin 1929, madje për veprën e tij janë mbajtur takime studimore edhe në të gjallë të tij.

“RRITJA PAS TRAUMATIKE”

MUNDËSIA E PËRMIRËSIMIT TË VETVETES DHE E SHNDËRRIMIT TË ASPEKTEVE NEGATIVE TË JETËS NË NJË BURIM TË TRANSFORMIMIT POZITIV KOLEKTIV

Tërmeti i 26 Nëntorit tronditi mbarë shoqërinë shqiptare e cila u zgjua në mëngjes me panic dhe me ndjesinë për ta kthyer atë në një gënjeshtëri. Në mbrojtje të një realiteti, qënia njerëzore është në gjendje të sajohet tipe të ndryshme gënjeshtresh për të mos lënduar të tjerët si psh gënjeshtër të bardha, gënjeshtër blu, gënjeshtër kompulsive dhe gënjeshtër patologjike. Më konkretisht çfarë ndodhi me ne në orët e para të mëngjesit të 26 nëntorit?

1) U zgjuam me një gënjeshtër të bardhë- në sferën sociale ka gënjeshtër të justifikuar, të ashtuquajturat gënjeshtër të bardha që pothuajse të gjithë ne i përdorim deri diku. Që nga koha kur mësojnë të flasim, fëmijët fillojnë të përdorin fjalë për të gënjer. Në psikologjinë e zhvillimit, e gjithë kjo, edhe pse mund të duket se është një kontradiktë, njihet si një shenjë e inteligjencës sociale. Prandaj, le të themi se ne dëshirojmë të përdorim gënjeshtër si një lubrifikant shoqëror se nuk donim të besonim se lëkundjet sizmike të tërmetit morën me vete edhe fëmijë. Oh jo, kjo nuk mund të ketë ndodhur...Për më tepër, ne jetojmë, rritemi dhe jemi të edukuar në kundërshtimin më të pastër.

2) U zgjuam me një gënjeshtër blu- janë ato të ashtuquajturat gënjeshtër blu që i themi kur nuk i besojmë vetvetes, kur duam të jemi pjesë e një grupi social. Me ta mundohemi ta bëjmë veten të pranuar dhe të ndjehe mi të sigurt, por edhe nga frika e asaj që do të mund të ndodhë në të vërtetë. Vërtet ne u frikësuam sepse nuk donim të besonim që kishin mbetur njerëz nëpër rrënojat e tërmetit e aq më tepër që të ishin shuar edhe familje të plota. E gjithë shoqëria do të rrëzohej nëse nuk mund t'i besonim njëri-tjetrit, por në të njëjtën kohë, me siguri, nuk do të mbetej e tillë derisa të gjithë të thonin të vërtetën e derisa grupe të angazhuara shoqërore nën mandatin social dhe institucional të viheshin në lëvizje për të nxjerrë jashtë trupat e tyre apo për tu ofruar material bazike për jetën apo për të rindërtuar shtëpitë e tyre.

3) U zgjuam me një gënjeshtër kompulsive - janë të ashtuquajturat gënjeshtër kompulsive kur bëhemi të varur nga tregimet fantastike dhe vuajmë nga pasiguri e thellë. Në përgjithësi, njerëzit e vetëm që lëndohen nga kjo lloj gënjeshtre janë vetë ata. Ata quhen gënjeshtarë të detyrueshëm. Në fakt jemi mësuar të dëgjojmë dal vivo dhe të shohim në media se u ndërtaun

pallate e ndërtesa të bukura dhe e kemi detyruar veten të mos besojmë se tashmë ato ishin shembur dhe ishin kthyer në rrënoja. Dhe kështu ndodhi, edhe pse e detyruam veten, në të vërtetë, ne u plagosëm shpirtërisht kur njerëzit mbeten nëpër çadra, nëpër shtëpitë mikpritëse të tjerëve apo nëpër hotele etj.

4) U zgjuam me një gënjeshtër patologjike - janë të ashtuquajturat gënjeshtër patologjike kur tregohemi

pësuar humbje të një personi, kush ka mbetur, kush ka humbur diçka të rëndësishme, kush ka luftuar kundër vdekjes mund të mësojë t'i përshtatet erës dhe stuhive siç bëjnë pemët... dmth duke zhvilluar rrënjë të forta dhe degë. Çfarë parashikoi Guida Providenciale për ne? Shenjat pas një traume mund të shfaqen në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe aspekte të rritjes si person..

Në lidhje me këtë të fundit,



të ftohtë dhe përllogaritës duke përmbytur objektiva dhe interesa specifike dhe zakonisht egoiste. Meqënëse shumë prej nesh kanë më shumë substancë të bardhë në zonën prefrontale të trurit kanë probleme me empatinë. Në fakt, një gjendje shtesë patologjike u krijua pasi për fatin jo të mirë mjaft njerëz nga shoqëria jonë luajtën rolin "sikur po u vijnë në ndihmë" personave që i shpëtuan lëkundjeve sizmike të tërmetit, njerëz të caktuar u sollën rreth e rrotull njerëzve në nevojë thjesht duke bërë një selfie apo duke treguar sjellje të tjera "fiktive"

Dhe ja, nga skenaret e krijuara në mënyrë të nënvetëdijshme të gënjeshtërave mbrojtëse, ne u futëm në Labirinthin Alkimik ku na nevojitej një Guidë Providenciale për të na treguar *materien e parë aktive* (prima materia) si dhe *rrugën e kthimit*. Gjatë këtij udhëtimit, ne përjetuam një traumë kolektive. Po, po, një traumë të vërtetë kolektive. Përvojat traumatike nuk janë një pikënisje e mirë; ato janë gjithmonë tragjike dhe psikologjikisht shkatërruese por ato mund të ofrojnë mundësi për tu rikuperuar. Kush ka

atëherë si është e mundur që pas vuajtjes të mund të përmirësojmë thellësisht jetën tonë? Dhe pse disa njerëz shtypen nga trauma, ndërsa të tjerët lulëzojnë përsëri?

Përjetimi i përvojave të rëndësishme dhe të dhimbshme sigurisht përfshin vuajtjet që manifestohen në marrëdhëniet me të tjerët dhe në jetën e dikujt. Por është gjithashtu e vërtetë që aspekte të reja të personalitetit mund të shfaqen nga vuajtjet. Sipas *prima materia* të psikologut Gustav Jung, kur dikush përvetëson vetëdijen, një pjesë e vetvetes, e cila deri në atë moment nuk ishte e panjohur, shfaqet dhe çdo marrëdhënie fillon të ndryshojë, duke supozuar tipare të reja.

Studimet tregojnë se shumë njerëz që kanë pasur një përvojë traumatike ose që janë përballur me prova jetësore tejet të ashpra, kanë treguar sesi përvoja të tilla negative mund të sjellin me vete një aspekt të fortë dhe të fuqishëm, duke përvetësuar një forcë misterioze të ndryshimit pozitiv dhe të rritjes personale.

Ne tanimë po flasim për një *rrugë të kthimit* nga trauma kolektive

e cila na orienton drejt një "rritje pas traumatike" që ka të bëjë me mundësinë e përmirësimit të vetvetes dhe të shndërrimit të aspekteve negative të jetës në një burim të transformimit pozitiv kolektiv. Mund të jetë një udhëtim i mundimshëm dhe rraskapitës por mund të hapë derën për një jetë të re. Është demonstruar gjerësisht se përvojat traumatike zakonisht çojnë në empati dhe altruizëm më të madh, duke përfaqësuar një motiv shtesë për të vepruar në interes të të tjerëve.

Në mbyllje; sa më shumë kemi pasur një përvojë traumatike për të treguar dhe për të kujtuar, aq më shumë kemi një Kopsht Edeni që pret të zbulohet. Sado i ngurtë të ketë qenë dimri, sado e dhimbshme vetmia dhe ndjenja e boshllëkut që ata kanë pësuar, gjithmonë ka në thellësi të secilit prej nesh një ballkon që pret të dalë në dritë: ballkoni ynë i brendshëm në kopshtin e natyrës dhe substancës. Ajo pjesë e jona që as ftohtësia e atyre që janë përreth nesh, dhe as pakujdesia dhe mungesa e respektit nuk arrijnë ta ndrydhin, të shkelin dhe ta vrasin.

Padyshim varet nga ne që të vendosim se çfarë duam të bëjmë me të: disa prej nesh janë të brengosur për mbrojtjen e tij, ngritjen e rrethojave shumë të larta. Dikush tjetër harron të dalë në ballkon e të ujisë. Në vend të kësaj, dikush e kultivon atë me dashuri, dhe kur ka mjaft lule, gjithashtu fton të tjerët ta shijojnë atë.

Përmbledhtazi, cila është forca misterioze që na lejon të dalim nga një situatë dëshpëruese dhe të kthehemi në një jetë të plotë? Ky qëndrim misterioz quhet "reziliencë" që përbën "Sekretin e rezistencës psikike..." për t'i rezistuar presioneve të mjedisit përreth; të presim përpara me optimizëm dhe për të vazhduar me atë vetëbesim i cili nuk e lejon veten të rrëzohet nga rrethanat, por synon me vendosmëri se çfarë është konstruktive.

Në këtë mënyrë, ne mund të gjejmë *rrugën e kthimit* të Labirithit Alkimik shqiptar, pa gënjeshtër ne mund të "rritemi pas traumës" duke treguar mirënjohje më të madhe ndaj jetës, identifikimin e mundësive të reja për ekzistencën e vetë personit, marrëdhënie më të këndshme ndërnjerëzore, një ndjenjë më të lartë të përgjegjësisë, jetë më të pasur shpirtërore dhe një lidhje me diçka më të madhe, një kuptim të forcës së brendshme.

Përgatitur nga:
Suela NDOJA

Nderohen me vlerësimet më të larta humane nga MISIONI DIPLOMATIK PËR PAQE E PROSPERITET I AKREDITUAR NË TIRANË, malsorët Shtjefen dhe Gjyste Ivezaj

“MOS I PRISNI KRYETARËT. BËJINI GJËRAT VETË, NJËRI PËR TJETRIN!” - NËNË TEREZA

E nisa këtë shkrim me këtë porosi të veçantë të Nënë Terezës, Nobelistes së Paqes & Shenjtores së Kalkutës e cila ka zënë vend më së miri në këtë mision tejet të veçantë në vlerësimin malsorëve, Shtjefen dhe Gjyste Ivezaj, pasi serioziteti dhe vlerësimi i tyre u bë falë hulumtimit dhe ndjekjes nga afër të veprimtarisë së këtyre malësoreve z. Ndue Dodaj, Misionar i Paqes & Anëtare Nderi i këtij misioni diplomatik si dhe pjesë e stafit të punës e veprimtarive që zhvillon ky mision në bashkëpunim me partnerët e vet ndërkombëtar, kudo në trojet etnike.

Ishte e rastësishme njohja apo dhe indicja që mori vëmendje ndaj çiftit Ivezaj te ky misionar, ku falë një veprimtarie në Shkodër e një bisede spontane me të, për meritat, punën dhe shembullin e pashoq që ky çift po i japin Malësisë dhe shqiptarisë në mbare botën duke e kthyer banesën e tyre në një Shtëpi Muze Historiko - Kulturor brenda së cilës gjinden koleksione të shumta që demonstronë jetën dhe veprimtarinë e malësoreve në rrjedhat e shekujve.

Bindja e tij për meritat e tyre çoi në atë që u finalizua me vlerësimet më të larta të këtyre malësoreve duke u miratua unanimisht nga vetë krerët e këtij misioni diplomatik duke i shpallur ata Misionarë të Paqes e njëkohësisht z. Shtjefen Ivezaj “Djalë e Malësisë” edhe Ambasador i Paqes, ndërsa Nënë Gjyste siç e thërrisnin të gjithë e nderuan me Medaljen e Arte të Urdhrit Nënë Tereza.

Ndaj me ju emocionet e rastit pasi dorëzimi i kësaj medalje, mu besua mua për çka do u jem gjithmonë mirënjohëse organizatorëve pasi u ndjeva shumë krenare që ky vlerësim i merituar ju dha malësoreve tonë Gjyste Ivezaj.

Kujtoj këtu edhe një thënie të përsëritur nga z. Petro Koçi Zv/ Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, se ky mision kishte arritur majat e vlerësimit duke ju referuar meritave të çiftit Ivezaj në fjali-



Momenti duke ju dorëzuar nderimi zotit Shtjefen Ivezaj



Moment, zonja Rita Shkurtaj, duke i dorëzuar nderimin zonjës Gjyste Ivezaj

min e tij të mbajtur gjatë kësaj ceremonie zyrtare..

Një organizim shumë serioz me një pjesëmarrje të gjere elitare nga fusha të ndryshme të jetës politike, shoqërore e humane e bënë këtë ditë të paharruar për

të gjithë ne që ishim prezent, çka u vu re edhe në emocionet e secilit që foli në këtë ceremoni.

Gjej rastin sërish ta falënderoj për zemërsisht ne emër të të gjithë malësoreve Guvernatorin dhe Ambasadorin

e njëkohësisht dhe koordinator i kësaj ceremonie, për seriozitetin dhe emocionet që na fali gjatë prezantimit dhe dorëzimit të këtyre vlerësimeve në emër të Misionit Diplomatik për Paqe e Prosperitet me qendër në Tiranë të z. Shtjefen Ivezaj dhe zj. Gjyste Ivezaj. Në ceremoninë e rastit ishin të pranishëm edhe shumë personalitete të larta shtetërore si: Gjeneral Dedë Prenga Këshilltar pranë Presidentit për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë. z. Koço Tahiri, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Mulla Fetah Bekolli një nga bashkëpunëtorët më të flaktë të Prof. Dr. Anton Çetës, luftëtar dhe komandant në luftën e UÇK -së edhe pas saj.

z. Ideal Qollaku, biznesmen i suksesshem prizrenas, z. Asllan Mazreku nga Malisheva, z. Nazmi Çela, z. Hysni Lila, z. Mustafa Kadiu, z. Hekuran Rrapaj e shumë të tjerë personalitete të shquar që i dhanë seriozitetin e merituar kësaj ceremonie. I pranishëm ishte edhe Rapsodi i Mirënjohur, Mjeshtri i Madh, kantautori Gjon Frroku i shoqërua me çiftelinë e tij ku përshëndeti të pranishmit me një këngë të rastit çka i dha edhe më shumë vlerësim kësaj ceremonie. Shënonte data 8 dhjetor ku kjo ceremoni përkonte edhe me datëlindjen e z. Ndue Dodaj gjë e cila nuk kaloi pa vëmendje, pasi Misioni Diplomatik i kishte përgatitur edhe një vlerësim enkas për këtë ditë duke i akorduar Medaljen e Arte si veprimtar i shquar i njerzimit si dhe Diplomën e Nderit nga UKB të miratuar nga të gjitha Organizmat Diplomatike Botërore Bashkëpunuese e të firmosura nga Prof. Dr. Madhu Krishan, Kryetar i Akademisë Botërore të Paqes. Ne shenjë mirënjohje e falënderimi z. Dodaj shtroi një drekë vëllazërore e tradicionale mirditore për miqtë dhe kolegët e tij.

**Përgatiti:
RITA SHKURTAJ**



Moment, zoti Peto Koçi, duke i dorëzuar nderimin zonjës Gjyste Ivezaj



Momente të nderimit të zotit Ndue Doda

88-VITE ARSIM NË HOT TË RI

Me rastin e 88-vjetorit të arsimit në Hot të Ri dhe 20 vjetorit të ndërtimit të shkollës së re “Dedë Gjon Luli” u organizua një veprimtari muziko-letrar nga grupi artistik i shkollës, në të cilën ishin të ftuar, prindër, ish mësues-ish nxënës dhe ish drejtues të kësaj shkolle. E ndëruan me pjesëmarrjen e tyre këtë veprimtari Shoqata “Martin Dreshaj” nga Peja, žnj. Valbona Tula drejtoresh për Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (ish mësuese në këtë shkollë), Sindikatat e Arsimit të Kosovës me përfaqësues Rrahman Jasharin, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” dhe Shoqata Malësia e Madhe. Familjarë të atdhetarit dhe mësuesit Palok Traboini, i cili shërbeu si sekretar i Dedë Gjon Lulit duke qene se ishte i vetmi Hotjan i shkolluar dhe njohës i shumë gjuhëve. Mjaftë emocionuese ishte dhe prania e ish-nxënësve, por edhe ish-mësuesve (Ndoc Dedvukës dhe Lec Mirit).

Veprimtaria festive u përshëndet nga Drejtori i Shkollës Gjovalin Kodra, i cili solli për të pranishmit një historik të pasur të arsimit në fshatin Hoti i Ri. Kolec Traboini, (fitues i disa festivale të filmit dokumentar dhe shkrimtar i njohur) tregon se babai i tij Paloka, në vitin 1930 do ta kthente shtëpinë e tij në shkollë në fshatin Hot të Ri (fshati u krijua nga disa familje të larguar nga trojet amnore Hoti dhe Gruda si rezultat i reprezaljeve mizore të Malit të Zi në popullatën vendase). Pra, 88- vite më parë në fshatin Hot i Ri do të hapej shkolla e parë e përbërë me 4 klasa, me 15 nxënës dhe çdo gjë drejtohej dhe financohej nga dashuria e atdhetari, mësues Palokës. Ishte emocionuese dhurimi i portretit të Palok Traboinit dhe libri I shkruar nga vetë Paloka për Luftën legjendarë të Malësisë së Madhe e drejtuar nga Ded Gjon Luli, nga Kolçji.

Gjatë këtyre viteve nga bankat e kësaj shkolle kanë dalë intelektual, artist, dhe sportistë me emër jo vetën në rangun lokal dhe kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Përmendim këtu Teuta Pashko Miri dhe Paulin Sadrin të laurar me çmime nga më të lartat në Shtete e Bashkuara të Amerikës. Përmend këtu përkthyesin Nikoll Daka, kompozitorin Zef Leka, Mundësin Gjon Leka, Mësuesen (që dy dite përpara ndërroj jetë), Kampionen në Atletik Luke Zefi- Çeka, Kryeprokurorë Françeska Lekani, këngëtarën Filomena Leka e të tjerë

Një falënderim i veçantë vjen për mësuesit e hershëm të kësaj shkolle, Muntaz Kokolarin, Marie Çefën, Selami Bushatin, Lirie Bushatin e të tjerë.

Ndërkohë në fshatin Hot i Ri shkolla 9 vjeçare, e cila mban emrin e Heroit “Dede Gjon Luli” sot mbushi 20 vite që nga koha kur është ndërtuar e re. Në këtë festë përshëndetën disa nga të pranishmit ku shoqatat e lartpërmendura shpërndan tituj “Mirënjohje” për shkollën dhe grupin e saj artistik, e cila gjatë viteve të fundit e drejtuar nga Gjovalin Kodra ka marrë pjesë në disa veprimtari Kombëtare në Shqipëri dhe Kosovë, ku është lauruar me çmimet e para. Tituj u ndanë nga drejtori



edhe për disa nga ish-mësuesit dhe mësuesen më të vjetër të shkollës Luçe Gjellaj. Shkolla është fitues e Festivali Folklorik “SADRA 2004” dhe e disa kampionateve në futboll dhe lojërat me dorë..

Këto suksese tregojnë për punën e mirë që është bërë nga kolektivi mësues –nxënës i kësaj shkolle në bashkëpunim edhe me bashkësinë.

Me rastin e 88-vjetorit të arsimit në Hot të Ri dhe 20 vjetorit të ndërtimit të shkollës “Dedë Gjon Luli” u organizuar një veprimtari muziko-letrar nga grupi ar-

tistik i shkollës dhe ekspozita në pikturë.

Spikat dashuria për profesionin dhe hulumtimi dhe ushqyerja e talenteve në këtë shkollë, e cila po korr suksese të njëpasnjëshme. Fryt i bashkëpunimit dhe punës së palodhur të kolektivit ishte edhe sfilata me veshjet tradicional të stiluar dhe të qepura me duart e tyre të mësuesve Dritës, Shukes dhe Vitores. Përgatitja e ekspozitës nga mësueses Armiri, Jehona e të tjerë. Një punë e mirë është bërë për mirëmbajtjen dhe zbulimin e shkollës nga drejtori Gjovalin, mësues

Ardmiri dhe të tjerët. Si program artistiko-letrar ashtu edhe ekspozita e pikturës tematikë kishin shpalosjen e ndjenjave kombëtare nga nxënësit dhe kjo u realizua me të gjitha komponentët mjeshtërisht. Tek duartrokitjet e shumta nxënësit dhe mësuesit morën frytin e punës së tyre të përkryer.

Në përfundim të veprimtarisë të pranishmit u bashkuan një koktejl

vëllazëror.

Veprimtaria festive u shoqërua dhe u pasqyrua nga mediat lokale, të cilat janë për tu lavdëruar në pasqyrimin e mirë të jetës dhe suksesit të kësaj shkolle.

Në përfundim kolektivit mësues-nxënës të Shkollës “Ded Gjon Luli” ju urojmë vazhdimësi të mrekullueshme dhe me plot suksese.

20 VJETORI I SHKOLLËS 9 VJEÇARE “DEDE GJON LULI”, NË HOT TË RI

Përshëndetja e Kryetarit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”:

Kam privilegjin, që në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe në emrin tim personal, t’ju përshëndes e t’ju sjelle urimet më të mira në këtë festë, në festën e 20 vjetorit të themelimit të shkollës suaj, që mban emrin e një nder figurat më të ndritura të nacionalitetit tone, në luftën e paepur për pavarësi e liri, të heroit të Popullit, Dede Gjon Luli.

Një nacionalitet pa shkollim, është i detyruar të shuhet.

Lumturia e njeriut përbëhet nga shkollimi e edukimi, jo nga pasuria, që fati i jep dhe i merr!

Njeriu analfabet dhe i paditur nuk sheh përtej hundës së tij dhe le të ketë sytë e vizion të shkëlqyer.

Nisur nga këto kërkesa të çdo kohe, por në veçanti në kohën e sotme për shkollimin e dijen, Konferenca e VI e shoqatës atdhetare “Dukagjini” e ka ndryshuar misionin e saj dhe është duke e përqendruar punën e saj te *Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinave kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri-tjetrin, të ecim përpara drejtë standardeve evropiane*. Por këtë mision mjaft të domosdoshëm në

çdo kohe dhe për çdo bashkësi, në veçanti ndalemi te bashkësi Dukagjinase kudo ajo është, Shoqata dhe në veçanti kryesia e saj nuk mund ta realizojë pa kontributin e të gjithëve pa kontributin e prindërve të djemve e vajzave, pa kontributin e mësuesve, pa kontributin e shoqërisë ku jetojmë. Prandaj, që këtë vit Kryesia e Shoqatës, ka programuar takimin me nxënësit e nxënëset më të mirë dukagjinase dhe ata të vitit të 9-të të nderohen me stimuj moral e të veçohen nga të tjerët, që të bëhen **shembull për të tjerët**. Gjithashtu, duke filluar nga ky numër gazete, ju sugjerojmë mësuesve, drejtorive të shkollave të paraqitin këta nxënës për ti publikuar në gazetën e pagëzuar me emrin e madh “Dukagjini”.

Për mos e gjate më tej, më lejoni tu lexoj letrën Presidenti i SHBA, Abraham Lincoln, që i drejtonte mësuesit të djalit!

Mësues i nderuar!

Djali im sot e fillon shkollën. Pas pak, gjithëcka do të jetë për të e re dhe e çuditshme, prandaj do të doja ta trajtonit butësisht. Është një aventurë që ai do ta marrë me vete nëpër të gjitha kontinentet. Të tilla aventura që ndoshta mund të përfshijnë luftëra, tragjedi dhe fatkeqësi. Ta jetosh këtë jetë, të duhet besim, dashuri dhe kuraja. Për këtë, i dashur mësues, do t’ju lutesha ta merrnit përdore e t’i mësoni gjëra që do t’i duhen t’i dijë, mësojeni atë, por butësisht, nëse mundeni.

Mësojeni se për çdo armik, ekziston një mik. Atij do t’i duhet të mësojë se jo të gjithë njerëzit janë të drejtë, dhe jo të gjithë njerëzit janë të sinqertë. Megjithatë mësojeni se për çdo faqezi ka një hero dhe se për çdo politikan egoist, jeton një lider i përkushtuar.

Mësojeni nëse mundeni se 10 centë të fituar kanë shumë më tepër vlerë se një dollar i gjetur.

Në shkollë, mësues, është shumë më e ndershme të dështosh se të mashtrosh.

Mësojeni atë si të humbë hijshëm, dhe si t’i gëzohet fitores kur ai fiton.

Mësojeni të jetë i mirë, me njerëzit e mirë, dhe i ashpër me njerëzit e ashpër.

Mundohuni t’i qëndrojnë sa më larg zilisë, nëse do të mundeni dhe mësojeni sekretin e një buzëqeshjeje të çiltër.

Mësojeni po të jetë e mundur, si të qeshë kur të jetë i trishtuar, dhe se të derdhësh lot nuk është aspak turp.

Mësojeni ti përqeshë cinikët.

Mësojeni nëse mundeni të zbulojë mrekullinë e leximit të librave, por gjithashtu i jepni edhe kohën e mjaftueshme për të kundruar misterin e përjetshëm të fluturimit të zogjve në qiell, të bletëve në diell e të luleve mbi një kodër të gjelbëruar.

Mësojeni të ketë besim në idetë e tij edhe nëse të gjithë do ti thonë se janë të gabuara.


Mundohuni t’i mësoni birit tim forcën për mos e ndjekur turmën edhe kur të gjithë vrapojnë pas fitimitarit.

Mësojeni të dëgjojë me vëmendje çdo njeri, por gjithashtu të shoshitë të gjithë atë që dëgjonte në sitën e së vërtetës dhe të marrë veç të mirën.

Mësojeni atij se si të shesë talentin dhe zgjuarsinë e tij tek ofertuesi më i lartë, por mos të pranojë kurrë asnjë lloj çmimi për shpirtin e zemrën.

Lejojeni të ketë kuraja për të qenë i padurueshëm. Lejojeni të ketë durimin për të qenë trim.

Mësojeni atë të ketë besim sublim te



vetvetja, sepse atëherë ai do të ketë gjithmonë besim sublim në njerëzimin dhe në ZOTIN.

Këto janë kërkesat, mësues, por ju bëni më të mirën që mundeni. Ai është fëmijë i vogël dhe i mirë DHE ËSHTË BIRI IM Me respekt, Abraham Lincoln

Të nderuar, morali i kësaj letre, nuk është thjeshtë vetëm për mësuesit, por në radhe të pare për prindërit dhe pastaj për mësuesit.

Drejtori i shkollës, zoti Gjovalin, me ftesën që na bëri, u realizuan dy të mira:

Së pari, ne jemi pjese e kësaj ngjarje të madhe, e këtij gëzimi për shkollën;

Së dyti, kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, u fut në punë, për të marrë vendimin, nr. 257, për të nderuar shkollën me titullin “**Mirënjohja Martin Camaj**”, me motivacion:

“Në kuadrin e 20-vjetorit të themelimit të Shkollës 9-vjeçare “Dede Gjon Luli”, në Hot të Ri, për punë të zellshme, me përkushtim, të të gjithë mësuesve, të cilët, me plot profesionalizëm dhe dashuri, u dhanë dije dhe edukim brezit të ri. Nxënësit e kësaj shkolle kanë qenë të suksesshëm në të gjitha përfaqësimet brenda e jashtë vendit”.

NDJENJA KRENARIE PËR NJË INSTITUCION TË DALLUAR ARSIMOR NË HOT TË RI

Bashkëpunimi vëllazëror nëpër vite i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe asaj të Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” kanë bërë që shumë njerëz nga Dukagjini i Kosovës dhe Dukagjini i Shqipërisë të njohën, të takohen dhe të këmbëjnë ide për integrimin kulturor të këtyre trojeve. Respekti i krijuar bëri që të jenë të ftuar nga drejtori Gjovalin Kodra në festën e përgatitur bukur te shkollës “Dedë Gjo Luli”. Ata po shënonin 88 vite të nismës së dritës së diturisë shqipe në këtë truall dhe 20 vjetorin e shkollës me emrin e atdhetarit heroit të kombit, që si e thotë kënga “Krujë e dytë, Vlorë e parë, Dedë Gjo Luli flamurtar”.

Në këtë festë të madhe ishin edhe përfaqësuesit e Shoqatës së Vëllazërisë



Kosovë- Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, kryetari Ukshin Jashari dhe veprimtari e vëllai i dy dëshmorëve të kombit, Ali Tahiri bashkë me kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës e Kulturës e Kosovës, Rahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri.

Para fillimit të programit festiv, ata janë takuar me kryetarin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Ndue Sanaj, me kolegun sindikalist Aleks Dushi, me veprimtaren e shoqatës “Dukagjini”, Roza Pjetri e me shumë vëllezër e motra duke zhvilluar biseda vëllazërore e duke hedhur ide për veprimtari të përbashkëta kulturore.

Në hapje të programit artistik drejtori i kësaj vatre arsimore, Gjovalin Kodra ka përshëndetur miqtë dhe gjithë pjesëmarrësit në këtë festë dhe pastaj pa shpalosur pjesë kujtimesh nga veprimtaria e këtij institucioni arsimor. Ai nuk ka fshehur gëzimin dhe krenarinë për arritjet e shumta në këtë shkollë në përpjekje për arritje sa më të larta në arsimimin dhe edukimin e brezave të kësaj pjese të Shqipërisë.



Pjesëmarrësit në këtë festë janë ndërë krenar me programin artistik që po shpalosnin nxënësit e kësaj shkolle të përgatitur me kujdes nga mësuesit e tyre. Duke falënderuar për festën e duke shprehur gëzimin që ishte pjesë e kësaj veprimtarie, kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës e Kulturës, Rahman Jasharaj ka falënderuar kolegun e tij sindikalist Aleks Dushi dhe vëllai Ndue Sanaj e Ukshin Jashari që me përkushtimin e tyre janë më të merituarit

që po vazhdon bashkëpunimi vëllazëror mes njerëzve të kulturës e arsimit nga Shqipëria e Kosova.

“Jam krenar me gjithë këto arritje e me gjithë këtë program artistik të përgatitur kaq mirë. Jam krenar me ambientet e shkollës këtu. Kjo shkollë dhe shumë të tjera janë dëshmi se institucionet në Shqipëri

e Kosovë duhet të jenë më të përkushtuara për arsimin dhe nuk duhet të zgjedhin gjuhën e kritikave për arsimin, shkollën, mësuesin e nxënësin. Ju përgëzoj për punën, përkushtimin dhe arritjet “, ka thënë Jasharaj për t’i dorëzuar drejtorit Kodra një mirënjohje të veçantë nga SBASHK-u për shkollën “Dedë Gjo Luli”.

Pas programit artistik pjesëmarrësit bashkë me drejtorin dhe mësuesit e kësaj shkolle janë gjendur në një koktej rasti, cili kaloi në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore përmes bashkëbisedave të lira.

**Përgatiti:
Roza Pjetri**

11 DHJETORI - DITA NDËRKOMBËTARE E MALEVE

- Mountains matter for Youth' is the theme of this year's International Mountain Day, which is celebrated on 11 December -

**MALET KANË RËNDËSI
PËR RININË!
ËSHTË TEMA E DITËS
NDËRKOMBËTARE
TË MALIT PËR VITIN 2019.**

Të rinjtë janë agjentë aktivë të ndryshimit dhe udhëheqësit e ardhshëm të së nesërme. Ata janë kujdestarë të maleve dhe të burimeve të tyre natyrore, të cilat kërcënohen nga ndryshimet klimatike.

Tema e Ditës Ndërkombëtare të Maleve 2019 është një mundësi e shkëlqyeshme për brezat e rinj të marrin drejtimin dhe të kërkojnë që malet dhe popujt malorë të bëhen qendror në axhendat e zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar, të marrin më shumë vëmendje, investime dhe hulumtime të përshtatura.

Dita do të jetë gjithashtu një rast për të edukuar fëmijët për rolin që luajnë malet në mbështetjen e miliardave lart dhe në rrjedhën e poshtme - duke siguruar ujë të ëmbël, energji të pastër, ushqim dhe rekreacion.

Dita Ndërkombëtare e Maleve është një shans për të nënvizuar se për rininë rurale, të jetuarit në male mund të jetë e vështirë. Shumë të rinj largohen në kërkim të një jete dhe punësim më të mirë. Migrimi nga malet çon në bujqësi të braktisur, degradim të tokës dhe një humbje të vlerave kulturore dhe traditave antike. Edukimi dhe trajnimi, hyrja në treg, mundësi të ndryshme punësimi dhe shërbime të mira publike mund të sigurojnë një të ardhme më të ndritshme për të rinjtë në male.

Dita Ndërkombëtare e Maleve si një dite e OKB, ka filluar e saj në vitin 1992, kur u bë miratimi i Kapitullit 13 të Agjendës 21 "Menaxhimi i Ekosistemeve të Brishtë: Zhvillimi i Qëndrueshëm i Malit" në Konferencën e Kombeve të Bashkuara

OKB) për Mjedisin dhe Zhvillimin.

The increasing attention to the importance of mountains led the UN General Assembly to declare 2002 the UN International Year of Mountains. Vëmendja gjithnjë në rritje për rëndësinë e maleve bëri që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së të deklarojë në vitin 2002 Vitin Ndërkombëtar të Malit të OKB-së. On this occasion, the UN General Assembly has designated 11 December, from 2003 onëards, as "International Mountain Day". Me këtë rast, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka caktuar 11 dhjetor, që nga 2003 e në vazhdim, si "Dita Ndërkombëtare e Malit". The Food and Agriculture Organization of the United Nations (FAO) is the coordinating agency for the preparation and animation of this celebration (IMD) and is mandated to lead observance of it at the global level. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO) është agjencia koordinuese për përgatitjen dhe animimin e këtij festimi (IMD) dhe ka mandat për të udhëhequr respektimin e saj në nivel global

Përgatiti: Gjon Fierza, AKM, 2019



NË PARMA VENDOSJET BUSTI I GJERGJ KASTRIOTIT

Ditën e shtunë, me 7 dhjetor 2019, në orën 10.00, në parkun "Kennedy via Bizozzero", u bë ceremonia e vendosjes së bustit të Gjergj KASTRIOTIT, me pjesëmarrjen e bashkatdhetarëve që jetojnë në Parma.

Mori pjesë kryetari e bashkisë Federico Pizzarotti.

Një nëpunëse e ambasadës shqiptare Milano, foli për jetën e heroit dhe lidhjen midis 2 popujve. Pastaj, mbas dite, në 18.00, në katedralen e qytetit, ishte një tubim tjetër, ku foli prifti Matia Elia, që jeton në Itali dhe një hoxhe nga Shkupi dhe një albanolog e mësues gjuhe gjithashtu nga Shkupi pastaj u bë & mesha.

Xhiljola Shala, Parma



LUMNIMI I NJI MARTESE TË MALLKUEME

(Vijon nga numri i kaluar, nr. 193)

III

Fejesa e çikës së bajraktarit të Shalës ra papritur si bora në gusht. Shalë e Krasniqe rrinin në dy llogore fanatike paragjyqese. Ma lehtësisht rrafshohej Kakija se me u ba martesë mes një kaureshe e një "turku". Sofia kje nusja e parë dukagjinase që shkeli Malësinë e Gjakovës. Te kjo nuse Zoti kish bashkue bukurinë fizike me virtytin shpirtnor. E gjatë, e shëndetshme sa duhet me rrejtë trajtat klasike në harmoni mes linjave. Fytyrë pranverore, transparente si gatarja. Prej babës kishte marrë karakterin e fortë, nga nana ambëlënë, zemrën dhe ndershmërinë. Kah shkante te kisha apo kur delte me dele në Trojtë madh, djelmia thonin: "Fal, Zot, sy me pa! Lum kush e ka fat me e pas në konak!" Dasma u ba në vjeshtë, krushqit erdhën me kuaj të bardhë dhe e morën me lodër e batore pushkësh. Sofia qau me kuje e mallëngjim të thellë zemre. Ajo kurrë nuk e kishte kalue Qafën e Ndërma-jave, as dalë prej pellgut të Shalës.

Shumica e dasmaxhive nën za thonin:

- E mjera kjo çikole për fatin e zi që i ra! Si ia plasi dreqi sytë bajraktarit dhe treti ketë farë azganet në turqeli?

Famullitari i Shalës, Patër Zefi, u habit pa nga kjo fejesë e ndalueme dhe shkoi në kullë të Lul Shalës

- Bajraktar, a thue nuk pati kshtenimi i maleve as një djalë të denjë për çikën tande?

- Qebesa martesë asht me shkrim, more i bekuem.

- I Pari i Shalës shkeli i pari Shkrimin e Shenjtë e po ta kish ba dikush tjetër, do e kisha dënue sa edhe malet do ishin lig-shte nga pesha e mallkimit.

- Patër, fjalë boll të randa po thue, por nuk jam për to. Ti je njeri i Zotit, por nuk je ma i madh se Shën Kollit. Për hatër të Shën Kollit kena dalë bashkë e pajtue gjaqe e varrë. Për hatër të Shën Kollit e bana ketë fejesë dhe nuk kam ndërmend me ndejtë kryeulun para teje, as kërrkujt ndër male. Krishti nuk thotë me urrye as të pafetë, as besimtarët e tjerë.

Bajraktari me ketë fejesë tronditi tabutë dhe pa vra mendjen hapi një shteg, që nuk do mbyllej ma. Gjithmonë ka një të parë dhe ky i parë në lidhjen martesore mes kryqit dhe Kuranit në malësi u ba bajraktari i Shalës

Çikën, kjo brengë e madhe e mundonte më shumë se këdo dhe e shtinte në mendime shqetësuese. "Mirë se po martohem pa dëshirë, por si ia baj po më detyruen me ndërrue fe?! Unë jam ligjue në Kishë të Shalës, po kur të shkoj atje çka do bahet me fatin tem?" Sofia kjau me lot të ngrohtë per nanën që adhuronte si perëndeshë dhe për motrat me të cilat nuk kishte kthye kurrë kjoftë edhe një fjalë prishaqefe.. Qau edhe për vëllanë e vetëm, Mark Lulën; lotët e tij kur e mori grykë nuk do i shlyhen kurrë nga kujtesa. I dhimbej baba ndonëse e martoi pa dëshirë. Gjithsesi fytyra e tij e vërejtun dhe e dëshpërueme fliste shumë. Ndihej

në faj si prind dhe besimtar, por kryenaltë para dokeve burrnore. Çika me duvak të bardhë ia bani hallall të gjitha, e përqafoi para se të nisej dhe i tha:

- Tatà, mos rri i mërztun! Ti je bajraktari Shalës dhe te tanë i kanë sytë te ti. Unë jam çika jote dhe mbaje kapuçin nalt për mue sa të jesh gjallë!

Martesa e çikave në malësi përjetohej gati si gjysmë jaze, për shkak se ishin prindërit që vendosnin. Çikat nuk kishin idenë se ku po shkonin, as kishin pa me sy kë po merrnin, ky ishte shkaku kryesorë që qanin me shumë përmallim, prandaj fjalët ngushëlluese ishin:- "A u mërztite për çikën?", apo "Paç baftin!".

Ajo ditë dasme pa kangë qe një dramë e randë dhe per Cel Bobin, i cili mallkoi në heshtje skifterin e Valbonës që erdhi



Kulla e Micit
Bjeshka e Pevcajve

e rrëmbeu dallëndyshen, që ai adhuronte dhe për gjithë botën nuk e ndërronte.

Sofia ishte vajzë e zoja dhe kishte ditë me zbrapsë shpatinat dhe gucamat pa vend të tarabakve moshatarë të mëhallës kur shkonin me gja nëpër rudina. Nji ditë u gjet ngushtë e rrethue prej dy djemve të ri që nuk e lenin rahat tue e picatë, madje njeni, i rrëmbyem nga pasioni i zjarrtë, tentoi ta përqafonte, por Sofia i'u shmang dhe ia mbathi vrapit të flakërohej shkambit. Cel Bobi, që po kthehej prej gjoje me një lepur në krah doli prej imshite në ulicë dhe i preu rrugën çikës. E kapi me forcë përkrahu dhe i tha:

- Je në besë të Cel Bobit! Ju paçi faqen e zezë si nuk ju vjen marre me ba lojna të këqija me motrën tuej! Ikni, shkoni te lopët, se nuk due me fëlliq duart, se ju baj me u pshtue shurra në tllina. Celi ishte një djalë shumë i pashëm, i njerëzishëm dhe i pjekun para kohe, se ishte rritun jetim. Me Sofinë kishte shkëmbye shikime platonike në tre - katër raste rrugës kah shkonin te kisha. Magjia e shikimit e hipnotizoi në distancë derisa nji ditë Celi ia preu rrugën kah po shkante me mbushë ujë në krue dhe i tha:

- Për tanë çka nxe ky dielli të marr nuse!

- Hajde, më lyp te baba, poqe se ke tanë atë merak! -ia ktheu Sofia.

- Qebesa po tutem se bajraktari nuk më pranon për mik.

- Po u tute mos më dil përpara, se nuk më duhet gja një burrë frikacak!

- A po e shtje nanën shkuese, moj Sofije?

- Sa mirë po ditke more djal! Qysh kur ke ndie se vendosin gratë në shpinë bajraktarit të Shalës?

- Ke të drejtë çikò, por unë jam jetim; shpinë e kam jerevije, bajraktari kullë tre bojë, unë jam prej Bobit dhe Bajraktari nuk pranon dhëndër një djalë prej një dere që nuk ka vojvodë as bajrak. As një mashkull kurrë nuk kishte fol kaq njerëzishëm, as nuk e kishte ba per vete sa ky djalë "i pasoj". Sofia me një buzëqeshje engjël-

zemër, kujtimet e 18 pranverave. Ajo tashma ishte nuse e Mulosmanve dhe filloi një histori jete në naltësinë e sokole-shave dhe nanlokeve ma të fisme të maleve tona. Mbas një moti martesë Zoti i fali një kokërr djalë të shëndoshë si molla e të bukur si pranvera. Pushkët uruese krisën cep më cep të Krasniqes, jehona e tyre u ndie dhe u përcoll edhe në Shalë. Nga kulla e bajraktarit fisi, mësoi lajmin e mirë se i kishte le një nip i pagzuem që bark të nanës me emnin Sokol Rama. Mehmet Mulosmani, kah shihte nipin tue rritë si njomza, zemra i bahej mal dhe me shpoti i thoshte së resë:

- Nuse, kujt i ka gja ky pitrak djalë?

- I ka ngja të mirit, babò!

- Qebesa, moj nuse, asht si me pas marrë në lpungë prej Shale Mark Lulën e vogël e me prue në Fang. Si mali kur veshet me gjelbërim ky djalë ma ka përtri shpirtin. Nuse, Sokol Rama do vllazën dhe motra me luejtë e me u rritë bashkë si kingjat e një vathi.

Andrra e plakut u ba realitet. Bija e Shalës, Sokol Ramës, i bani dhuratë dhe dy djem dhe një çikë. Sokol Rama shkante te daja për çdo verë dhe çdo Shën Gjon. Mark Lula e mbante në prehën dhe e vinte në rend me burrat e maleve, që bujtnin në konak. Kur u ba bërbjek të gjithë thonin se për mend kishte ngja në Krasniqe, si landë e për zemër ishte shaljan tipik, picak i hijshëm ma shumë i gjatë se i mesëm, trup hjedhun si brejt në Valbonë. Sokol Rama nuk kishte veç 15 vjet ku iu ba krah i djathtë tatës për gisht.

Nji ditë pranvere, dy haramzade të marrosun të Krasniqes shkuen në torishtën e Ram Mehmetit, morën një pendë qe katër lavërsh, që nuk i kishin shokë për mirë deri në Gjakovë dhe i ndërruan me dy mzorë leshatakë, me crrule baglash të ngjton si rrodhe për bythë.

- Tatà, pse na i ndërruan qetë me viça?

- Njeshtu janë mësue me ba shpesh more bir. Janë cuba që prej shumë vitesh na dhetojnë.

- A kanë shula njato huta që i mbajmë vjerrë në tra?

- Po, more bir, por ka shumë mot që jena në zgrip për meshkuj dhe nuk kena mujtë me vra njerëz për planca viçash. Bolle randë asht, por trimnia pa urti e bjerrë vlerën.

- Tatà, ka ardhë dita me provue a si kanë plumbat hutat e Mulosmanve.

- Ta pasha hajrin, je i ri dhe nuk i di do punë. Tue u rritë e tash po i mëson.

- Pashà qiell e tokë nuk jam ka pres me u rritë ma! O me ngjeshë pishtolen tande o me veshë xhubletën e nanës!

Ram Mehmetit nuk i piu ujë fjala me zbutë guximin e pezmatuem të të birit. Djali, si vetima, hyni në kullë, futi topçen ne brez dhe ia mbathi vrapit për shkurt dhe u doli në kthesa e katundit dhetuesve, që mbanin për dore dy balojtë ka 100 okësh.

- A mujtit, more daji!

- Berqavers mirë boll na shkoj dita sot, nesër ditë e re nafake re!

- Ku e morët ketë pendë qe?

- Pse po na pvetë, a nuk e din? I morëm njaty ku i marrim

IV

Nusja në kalë të bardhë kaloi qafa e male tue lanë mbas, të shkrueme në

VËSHTRIM KRITIK MBI VEPRËN E GJEÇOVIT "KANUNI I LEK DUKAGJINIT"



Për veprën e Gjeçovit janë mbajtur shumë simpoziume dhe takime qysh nga vdekja tragjike e tij në vitin 1929, madje për veprën e tij janë mbajtur takime studimore edhe në të gjallë të tij.

Falënderoj organizatorët që me rastin e 90 vjetorit organizuan këtë simpozium plotësisht të merituar për veprën shkencore por edhe patriotike të këtij atdhetari të madh.

Gjeçovi gjatë jetës së tij 55 vjeçare zhvilloi një aktivitet atdhetar por edhe shkencor, duke na lënë një trashëgimi të pasur në fusha si arkeologjia, etnografia,

folklori etj duke mbledhur këngë, valle, gojëdhëna mitologjike, gjë e gjëza, fjalë të urta, proverba dhe materiale të tjera të cilat u botuan në fillim të shekullit të kaluar në revistën "Visaret e Kombit". Në harkun kohor prej gjashtë vitesh, nga viti 1904 deri në vitin 1910, ai botoi 5 vepra dhe përkthime.

Gjatë regjimit komunist në Shqipëri, me gjithë luftën e madhe që u zhvillua kundër fesë dhe veçanërisht ndaj klerit katolik, vepra e Gjeçovit u vlerësua duke i njohur meritën e krijimit të Arkeologjisë Shqiptare, duke e dekoruar me rastin e 50 vjetorit të shpalljes së pavarësisë në vitin 1962 me Urdhrin "Për Veprimtari Patriotike" të klasit III dhe duke botuar për jetën dhe veprimtarinë e tij një monografi me titull "Shtjefën Gjeçovi Jeta dhe Veprat" e shkruar nga Ruzhdi Mata, shtypur në shtypshkronjën "Mihal Duri", Tiranë 1982.

Përballë veprës kolosale atdhetare dhe shkencore të Gjeçovit, edhe ai regjim u detyrua t'i njihje shumë nga meritat e tij. Pushka e Gjeçovit u vendos në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë qysh në vi-

tin 1970.

Presidenti Rugova, me datën 10 qershor 2003, e ka dekoruar At Shtjefën Gjeçovin me "Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit".

Është detyra jonë që të identifikojmë dhe të nxjerrim në dritë veprën e plotë të këtij kolosi të atdhetarisë dhe të letrave shqipe dhe të sensibilizojmë organet përkatëse shtetërore dhe politike në Shqipëri dhe në Kosovë për të vënë në vendin që meriton figurën e këtij patrioti të madh.

Tema ime do të jetë e përqendruar nga një këndvështrim kritik, por njëkohësisht edhe dashamirës dhe jo denigrues për veprën madhore "Kanuni i Lek Dukagjinit" që e ka bërë të pavdekshëm emrin e autorit të sajë.

Edhe pse janë shkruar me qindra artikuj studimorë mbi këtë veper, duke e etiketuar në forma nga më ekstremet, nga cilësimi si një kryevepër deri në mallkim të sajë si një veper që bën të ekspozohen anët më të errëta të realitetit shqiptar, vazhdojnë akoma të shkruhen pa fund studime dhe referate për të.

Analizën më të saktë dhe të koncentruar të kësaj vepre e ka bërë në hyrje të botimit të parë të sajë korifeu i letrave shqipe Atë Gjergj Fishta.

Në sesionin shkencor që u mbajt në Zllakuqan me datë 25 korrik 2017 jam paraqitur me një temë me titull "Gjakmarrja në veprën e Shtjefën Gjeçovit". Aty kam folur me hollësi për problemin e gjakmarrjes dhe trajtimin e këtij fenomeni nga Kanuni i Lek Dukagjinit. Tema është e botuar dhe mund të gjendet me lehtësi, prandaj sot nuk do ta trajtoj aspak këtë temë.

Në vitin 1960, në revistën shkencore "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës", Seria Shkencat Shoqërore, volumni II, faqe 95, është botuar një studim mjaft serioz nga studiuesja ruse J. V. Ivanova mbi veprën "Kanuni i Lek Dukagjinit".

Në vijim të studimit të sajë, kjo studiuese, në faqen 96, për të kuptuar më mirë veprën e Gjeçovit ajo ka shtruar tre pyetje: Cilës kohë i përkasin informatat që sjell ai në veprën e tij;

Në çfarë trualli ka vepruar Kanuni i Lek Dukagjinit;

◀ për çdo pranverë!

- Deshta me u thanë se pranverat nuk vijnë njisoj. Sot bani mirë me i lidhë aty ku ishin e me marrë me veti ata viça të skurliqun si latë në vend të qeve.

- Ata viçat mbani mirë se kur të bahen qe vijnë e i marrim prapë!

- Pashë ketë ditë, nuk merrni ma kurrë qe as viça! Zbythuni e i lidhni ku i morët qetë e mi.

- Lapec, na u hiq sysh, se po të lidhim edhe ty për bishtit të kaut; - foli gërmushëm njeni "taksidarë"!

- Po u kallëzoi si po u del ma mirë, përndryshe paçi veten në qafë!

- Çka na kallëzon ti, more kopili i kaurres së Shalës?!

Sokol Rama u kallëzoi çka meritonin. Nxori dhetshen, i dha flakë rrufeshëm tue palue pa jetë njanin prej plaçkitësve. Tjetri mbushi kacaturrën, por nuk i dha puna afat, se djaloshi u tregue ma i shpejtë, tu e pulke me një shigjetë rreje në dorën e djathtë. Pushka i pshtoi prej dore e i ra për tokë, leqet iu lidhën nëpër kambë dhe qetë, të trembun prej gazepit, e ngrehën zvarrë nëpër ograjë. Katili cikaste si thi i egër dhe nuk dihet se ku përfundoi në një përrue, i varruem, i lamë në gjak, i bagluem prej qeve dhe marruem për jetë të jetëve.

Lajmi mor dheun në Malësi të Gjakovës e në Dukagjin. Gjithkush e uroi: "I lumtë pushka Sokol Ramës!". Nana Sofie, e befasue me nga trimënia e djalit tha:

- Tash, birò, u bane burrë! Ti vune në vend nderin e oxhakut, por ketë pushkë nuk e kam dëshirue! Zemra e lokes nuk



asht e qetë as një dekkik. Ata haramzade si e lypën e gjetën, por me pague një gjak e një varre sakate u duket pak kryet tat, more bir!

- Qebesa, kanë shkue gjak për gjak me plasat e qeve që i keni rritë ti e tata me tagji. Ta dinë tanë Malësia e Gjakovës se Mulosmanët as nuk gucin as nuk durojnë me i prekë sa grima. Sokol Rama e ngriti ma nalt autoritetin, pasuninë dhe prestigjin e familjes. Nji qind vetë me kenë me armë të ngrehuna e ai në mes, s'i tutej syni, s'i dridhej zemra me i ngrehë gisht malerës ma i pari. Sokol Ramën nuk guxoi kush m'e hangër sysh, as m'e shty për shefi, as me i prishë pleqinë. Me 24 pleq nga Malësia e Gjakovës dhe me dorëzani të Mark Lulës së Shalës e Bash Bajramit

të Nikajve, natën e Kurban Bajramit, pala e damtume në plaçkitje u pajtue me Mulosmanët. Sokol Ramës pushka nuk i bani ma bam ndër shqiptarë, por kundër armiqve që erdhën për me shkelë malet. Ai s'i njohu kurrë ushtarët e armikut, as numëroi armët e tij, besoi dhe u mbështet në trimëninë vet dhe shokëve të tij. "Kujt i ngjau Sokol Rrama, që u ba kaq i zot?" - pyesin burrat kah kuvendonin odave të malësisë. Krasniqe e Shalë e donin me xhelozë dhe kishin vështirë m'e nda se kah anon peshorja. Me hise gjaku e kishin barabar, prandaj Tunxh Mërturi kësaj dileme kureshtare i pati vu kapak:

- Miku i ngjet mikut, trimi trimit dhe i miri të mirit!

Motet rrodhën pa ia nda si ujë në Val-

bonë. Ashtu si Sokol Rama la në hije tat' e gjysh, edhe vetëm beti në hije të djalit. Çdo burrë dëshiron me u ba ma i mirë se baba dhe kënaqet po iu ba djali ma i mirë se ai vetë. Bekim i pikun prej qiellit për kullën e Mulosmanve piku Mic Sokoli. Nanëgjyshe Sofia e ushqu me ninulla, e mbajti në shuplakë të dorës tue e dashtë si dritën e diellit. Askush nuk guxonte me ia prishë qefin për kurrëja Micit të gjyshes. Qysh ditën që nana i ndau gjijtë e deri sa u ba 13 vjeç nip e gjyshe fjetën bashkë rroka- rroka. Me duart e saj e ushqu kah u rrit, e përcolli dhe i tha uratë kur Mici u ba aktor kryesor i shumë ngjarjeve të kapërthyeshme me turk e shkja. Sofia uronte tue i thanë së resë:

- Kjoftë bekue ai bark që e lindi dhe ai gji që e ushqu ketë trim mbi tanë trimat e tjerë

Gjyshja e pa nipin e vet kah luftonte për vatan pa i ra syni qerpik, as pa u tundë prej topave të otomanit. Me top ia gjuajtën kullën, gjylet s'e shemben, as zjarmi, as flakët s'e kallën kështjellën ku kishte folenë Shqipja e Shqipnisë. Mic Sokoli luftoi e fitoi ma se nji herë dhe u flijua më madhështi të pa shoqe aq sa i doli kanga e gjithmonë dhe gjëkund këndueme:

*Mic Sokoli i Sokol Ramës
fjalë po i çon Mark Lulës Shalës:
Ndihmomë pak, o daja i babës!
Më kanë vu topat stomit t'arës,
stomit arës, rrethit oborrit,
me shembë kullat e Mic Sokolit.*

◀ Në çfarë rrethanash konkrete historike ka lindur Kanuni dhe në cilat ambiente shoqërore ka pasur fuqi.

Të tria këtyre pyetjeve ajo është rrekur t'u japë përgjigje nga këndvështrimi i sajë që, për hir të së vërtetës, për arsye të rrethanave politiko shoqërore të kohës, nuk mund ti shmangej krejtësisht ndikimit të ideologjisë zyrtare të kohës që ishte regjimi komunist.

Në temën time, do të përpiqem edhe unë, të jap versionin tim për këto tri pika, pa kopjuar idetë ose pikëpamjet e kësaj studiueseje të nderuar.

Nga të dhënat e publikuara deri sot pranohet që shënime për kanunin e Lek Dukagjinit, rreth dy mijë faqe dorëshkrime, Gjeçovi i mblodhi nga viti 1907 deri në vitin 1915 në famullinë e Gomsiqes ku punoi rreth 8 vjet.

Informatat që sjell në këto shënime, u përkasin këtyre viteve dhe vendi ku këto rregulla zbatoheshin ishin kryesisht krahina rreth e rrotull famullisë së tij dhe në Mirditë.

Mbledhja, por sidomos kodifikimi i ndarë në nene dhe kapituj të veçantë, është një punë shkencore që ka kërkuar shumë kohë dhe mund nga autori, dhe është një meritë e jashtëzakonshme e tij.

Zonat ku zbatoheshin kanuni me emrin Lek Dukagjini ishin kryesisht zonat katolike në fiset e Malësisë së Madhe, Nikaj Mërturi, Shala dhe Shoshi, 12 bajrakët e vegjël të Pultit, Thaçi, Berisha, Malësia e Lezhës dhe bajrakët e Mirditës.

Autorja që citova më sipër shkruan se ky kanun zbatoheshin edhe në Krasniq, Gash, Bytyç, Has, Lumë dhe disa vende të tjera me popullsi të besimit mysliman gjë që nuk është e vërtetë.

Në zonat me popullsi të besimit mysliman krahas kanunit ka vepruar edhe shëriati që ishte një e drejtë që e praktikonte pushtuesi turk në shumë zona.

Madje edhe në zonat me popullsi të besimit katolik që përmendëm më sipër, ky kanun nuk ka vepruar kudo njëjloj por ka dallime të theksuara.

Dera e Gjo Markut e kodifikuar në këtë përmbledhje të Gjeçovit i ka patur ato privilegje vetëm në bajrakët e Mirditës, por jo në zonat e tjera.

Në zonat me popullsi të besimit të krishterë dhe mysliman, fqinje me Mirditën ka vepruar një tjetër kanun i njohur si "Kanuni i Skënderbeut". Ky u mblodh dhe u kodifikua nga Imzot Frano Ilija dhe u botua nga Arqipeshkvia e Shkodrës në vitin 1993. Zona e Kurbinut ku vepronte ky kanun është shumë e përzier nga ana gjinore me popullsinë e fiseve të Mirditës.


Edhe studiuesi Xhemal Meçi ka botuar një përmbledhje mbi të drejtën zakonore me titull "Kanuni i Lek Dukagjinit, Varianti i Pukës"

Në fakt Gomsiqja ku e mori lëndën kryesore Gjeçovi për veprën e tij, është quajtur historikisht pjesë administrative e Pukës, edhe pse është me popullsi të përzier të fiseve nga Puka dhe Mirdita.

Nëse marrim parasysh ndryshimet e kësaj të drejte zakonore që vepron në fise pak më të largëta nga Gomsiqja si Nikajt, Mërturi, Berisha, Shala, Shoshi, Shkreli, Kelmendi, Hoti, Gruda etj atëherë rezultoni që ky kanun nuk është i njëjlojtë në zonat që përmendëm.

Edhe Xhafer Martini dhe Shefqet Hoxha kanë mblledhur të drejtën zakonore për Dibrenë dhe Lumën, krahina relativisht afër me zonën ku Gjeçovi mblodhi materialet për veprën e tij.

Me këto që shkruam më sipër marrim përgjigje dy pyetjet e para ndërsa për pyetjen e tretë duhet të ndalemi edhe pak. Kur e ka zanafillën Kanuni asnjëri nuk mund ta thotë me kompetencë fjalën e tij



sepse fatkeqësisht janë dy shkaqe kryesore që nuk e mundësojnë hedhjen dritë mbi këtë pikë. Së pari, në Shqipëri pushtuesi turk, gjatë kohës që e mbajti të pushtuar, ka djegur dhe shkatërruar çdo gjë të shkruar dhe së dyti vendi ynë ka qenë i nënshtruar disa pushtuesve si romakët, serbët, bullgarët dhe në fund edhe turqit.

Secili pushtues, në kohën e sundimit të tij, ka zbatuar dhe ju ka imponuar ligjet e veta popullsisë së nënshtruar. Janë të njohura ligjet e Kostandinit të Madh, të Justinianit, Kodi i Dushanit dhe disa ligje të tjera të cilat në periudha kohe të përcaktuara, janë zbatuar në popullsinë shqiptare. Po ashtu, gjatë sundimit rreth 500 vjeçar të pushtuesit turk, zbatimi i disa ligjeve të pushtuesit ka qenë detyrim. Edhe e drejta kishtarë e shkruar në disa kapituj të Biblës, duhet të pranojmë që në popullsinë e krishterë ka pasur ndikimin e vet.

Nuk jemi në gjendje për të përcaktuar me saktësi ndikimin e secilit nga këto ligje, cili ka më shumë ndikim në Kanunin e Lek Dukagjinit por, sipas mendimit tonë, secili nga këto ka, pak a shumë, një farë ndikimi mbi të.

Mbas vitit 2000 studiuesja italyane Luçia Nadin dhe studiuesi shqiptar Pëllumb Xhufi kanë publikuar Statutet e Shkodrës nga një kopje dorëshkrim e ruajtur në Bibliotekën e Muzeut Correr në qytetin e Venecias.

Ky dokument me rreth njëqind faqe, është shkruar rreth vitit 1479 dhe ka një rëndësi të jashtëzakonshme për studimin e së drejtës penale dhe zakonore në

truallin Arbëror dhe për këtë është shkruar dhe diskutuar shumë në Shqipëri dhe jashtë sajë, por unë e përmenda këtë për faktin se në asnjërin nga nenet e këtij Statuti nuk përmendet gjakmarrja.

Shkodra ka qenë qyteti kryesor për rrethinat ku ka vepruar Kanuni i Lek Dukagjinit dhe ne nuk jemi në gjendje të themi se sa kanë pasur ndikim statutet e Shkodrës në popullsinë e rrethinave të

sajë. Nuk jemi në gjendje as të themi me siguri se kur ka filluar të shfaqet fenomeni i gjakmarrjes në formën që kishte kur shkroi Gjeçovi veprën e tij.

Në veprën e Gjeçovit nuk thuhet se kur ka filluar të shfaqet fenomeni i gjakmarrjes në mënyrë të frikshme siç ishte në vitet e fundit të pushtimit turk.

Mbetet detyrë parësore e studiuesve tanë për të bërë kërkimet e nevojshme në arkivat e ndryshme, kryesisht në ato të Romës, Venecias dhe Dubrovnikut për të parë se si ka evoluar ndikimi i kanunit në zonat ku ai pati ndikim.

Kanuni në secilin lloj ose variant, zbatohet brenda një njësie jo shumë të madhe që njihet me emrin fis ose bajrak.

Fise quhen grupime pak a shumë të mëdha banorësh që e kanë prejardhjen nga një i parëllindur dhe kanë të gjithë lidhje gjaku midis tyre. Nuk ka qene zakoni të bëheshin martesat brenda fisit as kur ishin larg njëzet breza. Në kanun ishte e ndaluar martesat brenda fisit "edhe në 400 breza", mjaft që lidhja e gjakut të ishte e njohur dhe e konfirmuar mirë.

Bajraku është një njësi territoriale me banorë që ishin të lidhur nën një flamur por jo domosdoshmërisht kishin lidhje gjaku midis tyre.

Në disa punime është shkruar se bajrakët dhe bajraktarin i krijoi pushtuesi turk. Kjo nuk me duket shumë e besueshme sepse asnjë shtet nuk mund të krijojë as fshatra as qytete as fise por ai, mund të bëjë ndarje administrative mbi bazën e fshatrave, qyteteve apo fiseve dhe të krijojë llojin e administratës që e vlerë-

son më të vyer. Organizimin administrativ mbi bazë bajraqesh pushtuesi turk e ka përdorur, më së pari në shekullin XVIII. Ai u ka njohur pushtetin bajraktarëve, ju ka dhënë disa kompetenca dhe ju ka njohur disa privilegje, dhe ka lejuar qeverisjen jo sipas ligjeve të shtetit por sipas të drejtës zakonore.

E drejta zakonore pësonte rregullime dhe ndryshime sa herë banorët e shikonin të arsyeshme. Ndryshimi bëhej nga mbledhja e të gjithë pjesëtarëve të fisit ose bajrakut, duke marrë pjesë siç thuhej "burr për shpi" çka nënkuptonte që të ishte i pranishëm në kuvend nga një pjesëtar mashkull nga çdo familje e komunitetit. Vendimet merreshin me shumicë absolute me votim të hapur. Ato ishin të detyrueshme për zbatim nga të gjithë komuniteti pa përjashtim, përfshirë edhe parinë. Së bashku me vendimet përcaktoheshin edhe sanksionet për cilindo që nuk zbatonte vendimet e miratuara. Masat shtrënguese kanë qenë shumë të rrepta dhe fillonin nga gjobat që mund të ishin me para ose me shtrimin e drekave ose darkave për të gjithë komunitetin, dhunimi publik duke e detyruar fajtorin të merrte një gur të rëndë dhe ta transportonte i vetëm në një distancë që ata e shikonin të arsyeshme, dëbimi për tre vjet ose përgjithmonë nga vendbanimi dhe shkatërrimi i të gjitha pronave dhe djegia e shtëpisë. Në raste ekstreme ishte vrasja e personit fajtor ose vrasja kolektive. Vrasja kolektive ishte kur fajtori bënte një krim që fyente rëndë nderin dhe dinjitetin e fisit. Në këtë rast, fajtori lidhej dhe vendosej në një shesh dhe vritej duke e qëlluar të gjithë me armë.

Vendimet që merreshin ishin në shumë raste specifike vetëm për një fis ose bajrak dhe në këtë kuptim, Kanuni i njërit fis, mund të mos ishte i njëjlojtë me atë të fisit tjetër. Edhe në Kanunin e hartuar nga Gjeçovi, në shtojcën që është vendosur në fund bëhet fjalë për vendime të fiseve ose të djelmnisë të cilat janë marrë në kushte të caktuara për probleme të caktuara. Ky është shembulli i ilustrues më i mirë që Kanuni nuk ishte i shkruar njëherë e përgjithmonë por ishte në përpunim dhe ndryshim të vazhdueshëm dhe nuk ishte kudo i njëjtë.

Edhe pse janë shkruar shumë studime mbi të drejtën zakonore shqiptare gjatë afër 150 vjetëve të fundit, jam i mendimit se ka akoma shumë hapësira të pa studiuar dhe ka vend për studime të tjera të bazuara në të dhëna arkivore dhe jo nga mbledhja gojore në komunitetet ku zbatohet.

Shkrimi i të drejtës zakonore mbi bazën e intervistave dhe tregimeve nga banorët e komuniteteve pa u thelluar në literaturë dhe në dokumente arkivore, jep një produkt që lë shumë për të dëshiruar në lidhje me cilësinë dhe saktësinë e tij.

Gjeçovi ka meritën që ishte i pari që bëri mbledhjen dhe kodifikimin e kësaj të drejte zakonore, por jam i mendimit se ajo duhet studiuar me sy kritik dhe të plotësohet me të dhëna të reja nga studiues profesionistë dhe institucione prestigjioze shtetërore ose nga shoqëria civile.

Ju faleminderit

Nga Mark Palnikaj,
Tiranë me 07. 11. 2019

NJË DITË NË PREKAZ

Me 26 tetor 2019, pothuaj si ditë vere, me një diell pranveror, një grup prej katër vetash, anëtar të shoqatës atdhetare “Dukagjini”, me z Ndue Sanaj kryetar, Pashko Rajta dhe rapsodët Kol Aramadhi dhe Gjon Kosteri, u nisem nga Shkodra për në Prekaz të komunës Skenderaj për të marre pjese në veprimtarinë e VI të Ditës së Plisit

Kjo veprimtari ishte dita e fundit e veprimtarisë së VI të këtij manifestimi të përvitshëm, që organizohet në Kosovë prej gjashtë vjetësh, nga grupi organizator tashmë I njohur, aktori Ismet Krasniqi-LALA, shkrimtari Preng Buzhala, poeti Gjon Gjergjani dhe piktori Idriz Berisha

Ne ishim të ftuar në këtë manifestim tradicional.

Ne u nisem në mëngjes nga Shkodra për në Prekaz dhe arritëm në kompleksin e Jashareve rreth orës njëmbëdhjetë.

Pasi bame homazhe ne memorialët e Jashareve u nisem për tek kulla e Ahmet Delis, në Prekaz ku dhe organizohej manifestimi

Aty gjetëm qindra njerëz nga të gjitha trojet Shqiptare, që ishin pjese e kësaj veprimtarie, në Dita e Plisit

Në katin e dytë të kullës së Ahmet Delis ishte dhoma e burrave si kudo në trojet tona, në çdo kullë gurit ka një dhoma burrash, në të cilën nder shekuj janë mbledh burrat dhe kanë bërë kuvende dhe pleqërim për probleme të ndryshme

Një grup i vogël nga pjesëmarrësit u ngjiti në katin e dytë të kësaj kulle nga shkallet e gurta tradicionale që ishin mjaft në gjendje të mirë.

Pasi u ulem rrafshit si burrat motit dhe u sistemuam, kulla nuk zinte më shumë se 40 vet, manifestimin e hapi z Ismet Krasniqi-LALA, i cili pasi uroj mirëseardhjen, përshkoi rrugën 6 vjeçare të kësaj veprimtarie, arritjet dhe vështirësitë në realizimin e saj. Ne fund u dha fjalën studiuesve dhe të ftuarve të ndryshëm.

Studiues nga të gjitha trojet etnike dhe diaspora folën për lashtësinë dhe vlerat e veçanta të Plisit Shqiptar

Plisi i bardh Shqiptar është më i vjetri në botë, madje vetëm shqiptaret njihen me Plisin e Bardhe, thanë folësit e ndryshëm.

Pas pak, me kërkesën e të pranishmeve, që ishin jashtë kullës, në oborr e saj, u vendos që manifestimi të zhvendosej në oborrin e kullës së Ahmet Delis

Në oborrin e kullës folën shumë studiues dhe në mes tyre edhe Ndue Sanaj, i cili u ndal: Kënaqësi e dyfishte, së pari, marre pjese në këtë veprimtari, që sjell në ditët tona historinë e lashtësisë sonë të lavdishme dhe na thotë ne, brezit të sotëm e të ardhshëm, kush kemi qene dhe së dyti, përfaqësoj shoqatën atdhetare “Dukagjini” dhe përshëndes në emër të saj dhe në emër të rapsodëve Gjon Kosteri e Kole Aramadhi.

Grupi organizator, katërshja simpatike,

aktori Ismet Kraniqi, shkrimtari Preng Buzhala, piktori Idriz Berisha e poeti Gjon Gjergjani, i ka bërë dhe vijon ti bëjë një shërbim të madh nacionalitetit tonë, se ne duhet të dimë se kush kemi qene.

Ne kemi një prej ardhje shumë të lashtë në histori dhe me emër, çka na bën krenar. Robert d' ANGÉLY, te libri “ENIGMA-nga pellazgët te shqiptarët”, thekson se fjala PELLAZG, do të thotë i BARDHË dhe jo i egër, siç theksojnë disa anti-shqiptar ... Profesor Xhuzepe Katapano ishte dhe mbetet i vetmi albanolog, që studioj në themel prejardhjen e racës ilire, në veçanti nëpërmjet veprës së tij të famshme “Thoti – fliste shqip”, 12 mije vjet më parë. Ka plotë studiues shqiptar e të huaj, që shkruajnë për pellazgët, iliret dhe ne shqiptarët, pasardhës të tyre, që na bëjnë krenar për prejardhjen tonë. Prandaj e përsërisë, se këta katër burra të nacionalitetit tone, me këtë veprimtari që kane marre përsipër ta përgatisin e ta zhvillojnë në hapësirat e Dardanisë sonë, na bëjnë një shërbim shumë të madh të gjithë shqiptarisë dhe në emër të përfaqësuesve të shoqatës atdhetare “Dukagjini”, ju përgëzoje me gjithë forcën e shpirtit tim dhe ju uroj të vijoni me plote vitalitet ne vitet e ardhshme dhe besoj se vitin 2020 ta përgatisim e zhvillojmë në Kështjellën “ROZAFÄ”, në kështjellën e Agronit e Teutës, në Shkodrën tonë, ne bashkëpunim me Muzeun Historike të Shkodrës.

Ftesa e juaj, na bëri dy të mira, së pari të ndjejmë veten të privilegjuar që jemi përsëri pjese e kësaj veprimtarie dhe së dyti, futi në punë kryesinë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për të vlerësuar e nderuar katër kullat me emër të kësaj treve, të trevës së Skënderajve. Ajo, me propozim te kryetarit te këtij grupi, miratoi dhënien e titullit “Mehmet Shpendi”:

Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, me motivacion: “Adem Jashari simbol i rezistencës, luftës dhe lirisë për bashkimin nacional. Akti i tij heroik pasuron fletët e historisë tonë të lavdishme. Prekazi për jetë rrezaton rreze lirie, këtu u shkrua me shkronja të arta historia më e re e nacionalitetit shqiptarë”

Kulla e Heroit Ilaz Kodra - “Kulla e Bashkimit”, me motivacion: Top of FormBottom of Form “Kulla e bashkimit, dijës dhe e pushkës, çerdhe e UÇK-së. Në këtë tempull u morën vendime të rëndësishme për nacionalitetin tonë. Kulla, që e ngriti vetëdijen tonë për liri e bashkim nacional”

Kulla Muze e Tahir Mehes, me motivacion: “Për rezistencën ndaj pushtuesit serb, Kullë muze ku ruhet trashëgimia shpirtërore, materiale e luftarake e popullit shqiptar”

Kulla e Ahmet Delisë, me motivacion: “Për trimëri e solidaritet ndaj popullit të vet. Kullë që e ngrit moralin e krenarin për të kaluarën dhe të ardhmen ndër breza”



Propozimi dhe premtimi, që bëri Kryetari i Shoqatës, se në muajin tetor të vitit 2020, veprimtaria “Dita e Plisit” të organizohet e të zhvillohet në Kështjellën “Rozafa”, u prit me gëzim të veçante, me shumë duartrokitje dhe në fund të veprimtarisë me shumë përfaqime.

Në fund të këtij manifestimit u dha një program mjaft i pasur artistik, në të cilën grupi i ynë u paraqitem me dy kënge njëra maja krahu “Ka vjen dielli e ka bien hana Adem Jashar nuk ban ma nana” Dhe tjetra “Moj Kosovë mos thuaj se mbarova”, e cila u këndua nga Kole M Aramadhi dhe Gjon Kosteri.

Pas përfundimit të veprimtarisë, kryetari I komunës Skenderaj, organizoj një

dreke për të pranishmit dhe të gjithë së bashku kaluam një mbas ditë të këndshme .

Në darkë, në Shkodër, pas një dite mjaft intensive pune dhe kujtime të paharruare po edhe me një detyrë tashmë shumë të vështirë, sepse sezonin e ardhshëm, në ditën përmbyllëse të Ditës së Plisit, të veprimtarisë së shtatë do te presim miq nga gjitha trojet Shqiptare dhe diaspora në qytetin tonë, Shkodër Locen e të gjithëve.

Detyra dhe krenaria janë të mëdha për këtë veprimtari, por besoj se do ja dalim me faqe të bardhë të gjithë bashkë.

**Përgatiti
Gjon Kosteri**



TËRMETI DHE MALËSORI SHTATLARTË

Malësori, një burrë me shtat të lartë, me shpatulla të gjëra, sapo zbriti nga kamioni, futi duart në xhepin e brendshëm të xhakëtës dhe nxori portofolin. Shoferi e kuptoi dhe ia preu shkurt:

- Nuk ke me pagua gjë.

Malësori e shikoi drejt, me sytë e tij që kishin gjithmonë një shprehje krenarie dhe i tha duke buzëqeshur:

- E po t'u rrit ndera, or mik!

Të kjoftë udha e mbarë dhe na urdhno ndonjiherë nga katundi.

- Po, po! Kam me ardhë! - tha shoferi dhe pasi përshëndeti me dorë nisi kamionin. Malësori ende buzëqeshte e mendonte me vete: "Për besë, ka edhe djelm të mirë!"

Vellua e errësirës kishte nisur të mbulonte tokën. Ai me kryet lart si malet, bëri përpara. Ecte dhe trupin e mbante drejt. Moshë nuk i a pat përkulur kurrizin. Mori rrugën e fshatit që çante më dysh bregoret e maleve të mbuluara me dëborë. Dëborë kishte edhe mbi kodrina, mbi livadhe, mbi drurë, edhe në rrugë dëborë kishte. Ajo i jepte një pamje të bukur këtij peisazhi malor. Ai ndjeu erën e ftohtë dhe dehëse të natës, kopsiti xhyben e trashë, ngriti jakën e saj dhe ecte i çkujdesur. Nën këmbët e tij të mbathura me opinga dhe çorape leshi, dëbora kërciste "krrap-krrap-krrap". "Me siguri ata s'më presin- mendoj me vete.- Ata e dinë se unë jam ende në spital". Ai çante nëpër dëborë dhe mendja i rrinte atje, tek shtëpia e rrënuar nga tërmeti, tek njerëzit. Ai kishte dëgjuar për ditë në spital lajmet e gëzueshme që jepnin gazetë dhe radioja se nga i gjithë vendi kishin shkuar për të ndihmuar. Malësori i dëgjonte këto lajme dhe herë herë rrinte si i habitur. Aty në çarçafët e bardhë të

spitalit ai kishte kujtuar disa herë çastin kur toka u drodh, kur u ndje një zhurmë shurdhuese, kur një tra e zuri për fundi... Herë herë para tij hapeshin kujtime të largëta që e bënë në psherëtinte.

Ai e mbante mend mirë se edhe një herë tjetër pat rënë tërmet. Kishte shumë e shumë vjet. Atëhere pat qënë fëmijë. Shumica e shtëpive ishin rrënuar. Edhe atëhere kishte qënë dimër. E këta ishin struktur ku të mundnin nga të ftohtit. I kujtohej se si e shtrëngonte e ëma në gjoks për ta ngrohur. E ai qante, ca nga të ftohtit e ca nga tmerrit, kur shikonte shtëpinë të kthyer në gërmadhë. I ati pat kërkuar andej këndeje nëpër miq të holla për të rregulluar shtëpinë, por edhe miqtë ishin për t'u qarë hallin. Sa shumë kishin vuajtur ata dhe sa vjet iu desh të jatit të tij ta rregullonte shtëpinë! Këto shkonte ndërmend pothuaj çdo ditë në spital dhe një mëngjes i tha mjekut:

- Or zoti doktor! A po m'lëshon se due me ikë?!

- Si ore, të ikësh! - i tha mjeku. - Do të lëshojmë kur të jesh shëruar mirë.

- Jo, besa, der at'here s'jam tue ndejta malësori. Plaga pothuajse më asht mbyllë. Mandej ju a po ndigjoni se ç'po bahet? Kanë shkue me na ndihmue e po ndërtojnë shtëpitë tona e unë me ndej hala këtu. Jo he burrë, mos më koritni!

Mjeku qeshi. Më në fund, mbasi ja mjekuan edhe njëherë plagën dhe i dhanë porosi që të mos punonte, e lejuan të delte nga spitali. Ecte dhe nën këmbët e tij dëbora kërciste "krrap-krrap-krra-krrup". Në mend kujtonte fshatin, si e la para dhjetë ditësh, shtëpinë, njerëzit... "C'bënte Prenga, Mrika, Lokja? A do jenë strehues në ndonjë shtëpi"...Po i afrohej fshatit. Tej

dukeshin disa drita që lëviznin si xixël-lonja. U afrua dhe ca dhe dalloj në duar fenerë dhe pishtarë të ndezur.

Nuk u përmbajt më, por thirri:

- Or ju shokë! Një zë ju përgjigj: - Eeej.

- Çka ndodhë që po bridhni natën me pishtarë?

- Kush je ti? - pyeti njëri.

- Jam Ndou, bre, Ndou!

Një djalë 15 vjeçar sa dëgjoi këtë zë të njohur u turr me rrëmbim drejt tij dhe thirri:

- Babë! A je ti babë? Jam unë Prenga.

Ata u pushtuan të dy at e bir, të për-malluar si të ishin ndarë prej vitesh dhe s'gjenin fjalë për të kuvenduar. S'të kena prit sonte, babë, si ke ardhë, ti akoma s'je shëruë? - e theu akullin djaloshi. Jo, bir, jam shëruë. Plaga pothuajse m'u ka mbyllë. Pastaj, bir i babës, si mujshta unë me ndejtë atje. Erdha dhe unë me punue.

- Po, babë, ashtu asht. Djaloshi shikonte fytyrën e hequr të të jatit me një ndjenjë të thellë dashurie. Në atë kohë ishin afruar njerëz të tjerë. Nën dritën e zbehtë të fenerëve, Ndou pa fytyra të panjohura? Prenga ju drejtua të jatit: - Babë, këta kanë ardhur për të na ndihmuar. Malësori u shtrëngoi duart fort dhe i rroku në qafë. Prenga foli përsëri: - Asht baba jem. Ka kenë në spital, se u plagos ditën kur ra tërmeti. Miqtë e rrethuan prapë të porsaardhurin dhe ky i shikonte me dashuri ato fytyra të ngurosura nga të ftohtit, por që sytë e tyre shprehnin gëzim e forcë. "Ndoshta s'kanë pa ndonjiherë borë e s'kanë ndje kësi të ftohti të madh" - mendoj me vete. "Tani ata mund t'i gjejshe në ndonji dhomë të ngrohtë së bashkut me

familjet e tyre, tue përkëdhelë fëmijët, tue lexue ndonjë libër apo tue pjekë gështenja të ngrohta. Por ata kanë mendue ndryshe. Kanë mendue për të mirën e të tanëve." Pa e zgatur ju drejtua atyre:

- Çka po bani tash natën?

- Po mbajmë trarë e tulla, - tha një nga të ardhurit.

- Babë! - iu drejtua menjëherë Prenga. Shtëpinë tonë na e kanë ndërtue të re. Ke me e pa sa të bukur e kanë ba.

- Si! Kaq shpejt u ndërtue? - pyeti i habitur Ndou. S'ma ka prit mendja të bahesha kaq shpejt me shtëpi të re. Miqtë buzëqeshnin. Buzëqeshte dhe Prenga. "Sa i lumtur jam që ja mbrina kësaj dite, mendonte me vete Ndou dhe kujtonte ato vite vuajtjesh..."

Po i afrohejshin vendit ku më parë ndodhë shtëpia e vjetër. Atje në vend të saj ngrihej një tjetër e re.

Disa pika lotë filluan t'i rrjedhin në faqet e tij të ashpra. Ishin lotë gëzimi. Fytyra e tij, e pjekur nga dielli dhe era, me sy të mëdhenj, me vetulla të trasha, shkëlqente dhe dukej sikur shkrihej e tëra në botën që e rrethonte. Donte të thërriste, por e mbajti veten.

- Babë! Kanë me na ardhë dhe dritat shpejt.

- Po bir! Kanë me na ardhë.-tha ai dhe me kryet gjithmonë lart ju afrua pragut të shtëpisë, ku ju duk se lindi dhe njëherë.

Pastaj malësori duke u kthyer nga miqtë ju drejtua atyre:

- Urdhnoni, o burra, urdhnoni. Se po ma don zemra t'iu kem miq sonte, në votrën teme. Ata hynë një nga një e pas tyre malësori që shinte atje tej, larg, dritat e një kamioni që ngjitej qafës së malit.

1967, Alfred Papuçiu



VETQEVERIMI

Ceremoniali honorifik i Flamurit të vogël të Gj. K. Skënderbeut dhe ceremoniali i Flamurit me përmasa të mëdha i Vetqeverimit, me 28 nëntor 1912!

Ende sot mbas më shumë se 100 e ca vjet, Historia e keqinterpretuar dhe e falsifikuar?

“Flamurit me përmasa të vogla”, të cilin Aladro Castriota ia kishte dhuruar Eqerem Bej Vlorës, Ismail Qemali, ndër të tjerë flamuj të vegjël, i dha një prioritet më të madh honorifik, duke e nxjerrë si surprizë nga poshtë palltos dhe duke e vendosur në një qoshe të shkallave të ballkonit të Sarajeve, të Vlorajve (Xhemil Bej Vlorës), me dt 28 nëntor 1912. Ky ishte ai “Flamuri i fletur në palat e tij për 445 vjet, sikundër e deklaronte I. Qemali në Kujtimet e tija. Në fakt, ky flamuri i Aladros, nuk ishte origjinal, ishte një improvizim...

Nëpër po atë shkallare ballkon, kaloi dhe u vendos edhe një flamur i përmasave të mëdha me shtizë dhe litar, i cili kishte funksionin e qeverisë si Flamuri i Vetëqeverimit. Fillimisht ky u ngrit te Porta kryesore e Sarajeve të Xhemil Beut, pastaj pak orë më vonë u vendos në Skelë te shtëpia e Hysen Sharra. Aty, mbas nja një jave si mbaroi Kongresi i Vlorës, u ngrit në lartësi duke e mbërthyer mbi një shtyllë druri.

Ky flamur dhe nja 4 a 5 copë të tjerë u përgatitën nga Marigoja po atë ditë me 28 nëntor 1912, paradite, u ngjyrosën me bojë të zezë me një stampë shqiptonje që ia siguruan dom Mark Vasa e Petro Fotograf, u thanë me mangall e të tjera. Këto rezultojnë nga të dhënat që nxirren nga Kujtimet e veteranëve, kryesisht nga Petro Poga, M. Grameno, K. Floqi, J. Milaj, At Donat Kurti, e të tjerë, etë tjerë.

Po të hetohen me imtësi flamuri që paraqitet në tre burime botime të ndryshme rezulton i njejtë, por në dy prej tyre filmati duket i kthyer mbrapsht. Pamja, të cilën sa duket e ka deformuar rrudhosja e valëvitja e flamurit, jep një ide aparaente sikur kemi një shqiptonjë një kokëshe? Ndërkaq edhe vetë forma e flamurit që ishte botuar së pari me 12 dhjetor 1912 te gazeta vjeneze ka një qafë e dy koka. Në këtë gjendje, mbase Marigoja kishte edhe shtampa më të ndryshme?

Në një gjurmë që ne e kemi nxjerrë nga një fotografi e vitit 1912, e gjetur nga materialet e kolonelit Thomson, del se

kjo formë shqiptonjë që u ngrit po me 28 nëntor 1912 edhe te Sarajet te Porta edhe te Shtëpia në Skelë, duket si ajo forma e përfolur e Nemces?

Agron Luka



▲ Lajmi mbi autonomi pavarësinë në shtypin italian!



▲ Fotografi e nxjerrë nga Arkivi privat i Kolonelit Thompson, 1912. Flamuri i nxjerrë nga ne me shtizë e litar dhe me një pjesë të gjurmës së ish flamurit, i cili krahasohet me materialet e bot. nga Ekspozita e 25 vjetorit të Pavarësisë, 1937



▲ Ekspozita e viti 1937, Foto Marubi, dhjetor 1937. Në qendër: Proçes-Verbali i dt. 28 nëntor 1912, me mungesa korumi etj... mbi një flamur; Foto e madhe austriake e realizuar me delegatët e Kongresit; Flamuri i Vidit; Libri i publikuar nga S. Gopçeviq, 1914, Flamuri I Vidit me yll të bardhë.



▲ Botimi te gazeta RD, 16 tetor 1991, me propoziminme Projekt Ligjin per ndrrimin e formë shqiptonjës dhe pastaj më 1998 ishte bërë psuhman e shadet!; botimi i shqiptonjës autentike të Vulës së Gj. Kastriotit, te gazeta Zëri i Popullit, 25 nëntor 1962. Kjo duhet të jetë formë shqiptonja originale e autentike e Flamurit dhe e Stemës së Republikës.



◀ Pasaporta zyrtare të Shtetit Shqiptar në vitin 1925; Pasaporta personale e prindit tim Gjovalin Luka. Ndërkohë vulat zyrtare mbanin një formë tjetër të shqiptonjës, e ashtuquajtura “klasikegjiantë”.

▲ 28 nëntori, Dita e Flamurit, 1936, bot. gaz. DRITA; Kopjimi i flamurit dhe kompozimi thujtse identik, te botimi simbas Buletini i LANÇL, 28 nëntor 1944; “Dita e Flamurit, u bë dita dy herë e shenjtë, dita e bashkimit të popullit shqiptar”, bot. te Buleti i L.A.N.ÇL, dt. 30 dhjetor 1944, që boton Fjalimin e E. Hoxha, të mbajtur me dt 28 nëntor 1944.



▲ Paraqitjet grafike: Gazeta vjeneze, Das Interessante Blatt, dt. 12 dhjetor 1912, nr. 50 e boton e para këtë fotografikë si ceremoniali i prezantimit të Mëvehtësisë e Vetqeverimit, e zbuluar nga studiuesja Eleni Laperi! Po aty, kjo gazetë, boton edhe këtë shqiptonjën e qatur popullorçe e Nemces, e përshtatur me rrufetë në këmbë-kthetrat me çaponj, si shqiptonja e Zeusit e Akrokeraneve. Gazeta Liri e Shqiperisë, me 6 janar 1913, e boton po këtë fotografikë, por vini re: në një artikull redaksional të javës së 28 nëntorit 1912 e interpretonte si, Shpallja e Autonomisë! Po ashtu e ribotonte edhe Hist. Shqip., Vëll II, bot 1965, f 364, por me diçiturën e manipuluar; Ky Ceremonial te Ballkoni/shkallaria e Sarajeve të Selamllëkut e Haremllëkut të Xhemil Bej Vlora, ka qarkulluar edhe si Kartëpostale në vitin 1913.



▲ Dy telegrame nga Vlora në Vjenë për kontin Bertold. Nxjerrë nga P. Logoreci.

SHQYRTIME NË TOPONIMINË DHE HISTORINË E VJETËR TË ZONËS SË NIKAJ-MËRTURIT

Nga Genc Pecnikaj

Vetëm gjysma e materialit, gjysma tjetër numrin vijues

Territori ku shtrihet sot krahina e Nikaj-Mërturit ka qënë historikisht gjatë shekujve pjesë e asaj krahine të lashtë e në zë që quhej Pult. Por në kohëra, si emërtim krahine është tjetërsuar ose është tkurrur aq shumë sa që sot këtë e ruan vetëm një territor i vogël, si për të kujtuar sadopak të shënjuar in e një krahine të madhe të dikurshme shqiptare.

Përreth 13 shekuj emërtimin Pult e ruajti vetëm ndarja dioceziane kishtarë, populli thirrej "pultjan, i pultjan". Për një periudhë gati 300 vjet, në shekujt e XIV-XV si dhe në shek.XVI nën sundimin osman, krahina thirrej dhe si "krahina e Pjetërspanit" ose "viset e Spanëve", emërky i prijësve që i sunduan këto treva.

Çështje të onomastikës, pra me toponiminë dhe antroponiminë e kësaj treve, e kanë cekur dhe studiuar jo pak studiues, të huaj dhe shqiptarë, që nga J. G. von Hahn, Franz Nopça, At Zef Valentini, Fulvio Cordignano, Ermanno Armao, Nikollë Gazulli, Rrok Zojzi, Kolë Luka¹, Kahreman Ulqini, Selami Pulaha e së fundmi Mark Palmikaj, Robert Elsie, etj. Gjithashtu me studimin e toponimisë së kësaj treve janë marrë dhe studiues sl-lavë.

Për vetë objektin e shqyrtimit, ne do paraqesim vetëm toponiminë e pjesës që sot quhet krahina e Nikaj-Mërturit (shkurt. N-M), dhe pse kjo duket sikur e ka "fragmentarizuar" vështrimin, sepse vetë krahina Nikaj-Mërtur është një identitet relativisht i vonë i dy shekujve të fundit, por këto vënde siç e thamë, kanë qënë pjesë e një entiteti më të madh.

Burimi kryesor i të dhënave janë defterët osmanë pas pushtimit ose regjistrat e tatimeve, relacionet e misionarëve katolikë nga famullitë vëndase ose të dërguar me mision nga Vatikani, si dhe burimi nga hartat e kohës. Por janë cituar dhe burime të tjera të shtrira në kohë nga shek.XIV e në vazhdim.

1. Nikaj - Përgjatë shekujve, sipas dokumentave, në këto anë të Pultit kanë ekzistuar dy vëndbanime që ngjasojnë në emërtim: I pari dhe më i vjetri *Nikajt* e Pultit përmendet deri nga fundi i shekullit të XVI-të, dhe i dyti pas 1628 e më vonë, si *Nicagni* (shqiptohet: *Nikajni*, ose *Nikajt* e sotëm).

Vendbanimi 'Nikaj' - në defterët osmanë del për herë të parë me 1485² (Def. Shkodr.1485), por dhe një shekull më vonë me 1582³ (Def. Shkodr.1582).

Ka shumë pak shtëpi me 1485, vetëm 7 zjarre; nuk dihet se sa zjarre janë shtuar për 100 vjet, pasi vendi është kryengritës dhe funksionarët osmanë nuk hynin dot për regjistrim, por tatimi pothuaj është pesëfishuar, nga 350 akçe në 1485, në 1500 akçe në v.1582.

Në fakt *Nikajt* e Pultit dalin në dokumentet sllave, rreth 150 vjet përpara atyre osmane. Pikërisht në diplomën (krisobulën) e themelimit të Manastirit të Deçanit të vitit 1330 (ose 'Statuti i Parë i Deçanit' siç njihet nga studiuesit), lëshuar nga mbreti serb Stefan Uroshi i III-të, thuhet që "..... për Manastirin e Deçanit ngarkohen dy altinjanët (*Altinjanina*) Zaharia dhe Mikael nga *Nikajt* e Pultit (u *Pilote u Nikite*), ti japin kësaj kishe fshikëza mëndafshi për çdo vit, Zaharia 4000 dhe Mikaeli 2000 copë"⁴, pra gjithsej 6000 fshikëza.

Me sa duket, e vetmja e dhënë e mjegullt mbi *Nikajt* e vjetër nëse shtriheshin apo jo në trojet e sotme të N-M, është e fshehur në vetë objektin se për çfarë përmendet ky fshat: pra për detyrimet në fshikëza të krimbit të mëndafshit. Sipas etnografit të shquar Rrok Zojzi sasia prej 6000 fshikëzash prodhon rreth 34 metra pëlhurë⁵ mëndafshi, pra shumë kjo e konsiderueshme që na tregon një prodhim të bollshëm. Mëpas duke ju referuar studiuesit Milan Shuffaj⁶, Zojzi thotë se "...edhe në krahinën e Pultit ka pasë zhvillim të madh kultura e mëndafshit...", dhe ku citon vetë Shuffajin se "... Jo vetëm në Shkodër në vjetin 1397, por dhe në Drisht në vjetin 1402, përmendet dogana e mëndafshit". Drishti në atë kohë ishte në kufi me zonën e Pultit, pra dhe një nga pikat hyrëse të këtij malli të çmuar nga kjo krahinë malore. Kjo krahinë ishte nën zotërimet e Spanëve, dhe siç thotë dhe studiuesi çek Konstantin Jireček⁷ "...zotërimet e Spanëve shtriheshin në shek.XIV deri në Drisht, si proniarë të mëdhenj. Si të tillë i gjejmë dhe në Shkodër në shek.XV, dhe njëri prej tyre Andrea Spani merrej edhe me kulturën e mëndafshit".

Por a mund të ketë lidhje kultura e krimbit të mëndafshit me zonën e N-M? Në fakt, dhe në kohët e sotme, në fshatrat e zonës së N-M, dhe sidomos ato të fundit të luginës, është mjaft e përhapur pema nga e cila ushqehet krimbi i mëndafshit: pema e manit. Gjithashtu dhe kushtet klimatike për mbarështim të krimbit, e mundësojnë dhe nuk e përjashtojnë këtë gjë. Kujtojmë se mëndafshi ishte një mall luksi në atë kohë, shumë i kërkuar përgjatë gjithë mesjetës e deri vonë, pra do të ishte mëse e arsyeshme dhe me leverdi që të mbarështohej krimbi i mëndafshit.

Po ndalemi pak tek një term interesant që u cek te diploma sllave e vitit 1330. Siç

e pamë këta dy persona nga *Nikajt* e Pultit, thirren dhe si "altinjanë" (sllav. *altinjanina*) pra nga viset e *Altinit*, siç quhej ndryshe në mesjetë, sidomos në burimet sllave dhe osmane, treva e sotme e Malësisë së Gjakovës me alpet përreth. Fjala ka rrjellë dhe në burime perëndimore si *Letia*⁸, por dhe në traditën vëndase si *Krahina* ose *Lugu i Ltisë*⁹. Origjina e emrit nuk është nga gjuha sllave por latine, nga lat. "altus" - i lartë, plus prapashtesën indoeuropiane -in. Pas pushtimit të këtyre zonave, turqit e mbajtën emrin e vjetër të paktën një shekull në dokumentat e tyre, kështu *Altin* u bë *Altun ili*, që do të thotë 'Toka e artë', ose 'Viset e arta'. Pra serbët, thjesht e mbajtën emrin e vjetër 'Altin' që gjetën për ato troje. Gjuha shqipe të intrigon edhe për këtë rast, pasi ka ruajtur të dy semantikën "e lartë" dhe "e artë" në një rrënjë fjale të vetme 'lart/nalt', ndarë në të dy dialektet e saj: *e n-alt-ë* (geg.) dhe *e l-ar-të* (tosk.). Pra kuptimi vjen i plotë në shqip kur thuhet: *viset e Altinëve*, ose (*n*) *altinëve*, pra ata që jetojnë *nalt* (*lart*) në male, ose pse jo 'Alpinët dardanë' n.q.s. citojmë veprën antike "Notitia Dignitatum" (Bur.Hist.Shqip.vëll.I-rë). Fjala në shekuj ka derivuar dhe në trajta të tjera si (*m*)*altinë* ose *mal(t)sorë*. Me siguri, këtë ka pasur parasysh dhe një studiuese serbe, kur i jep si padashur vëndin e meritës gjuhës shqipe, dhe deklaroi se: "...Në fakt, emri shqiptar i krahinës 'Malsija', ose 'Malçija' (e Gjakovës - G. P.) e rikthen kuptimin origjinal të Altinit të vjetër; duke e shënjuar atë që nga majat madhështore të maleve, me shpatet e mrekulueshme alpine, e deri te luginat dhe brigjet e baseneve më të ulëta të lumenjve"¹⁰.

Pra '(n)Altinët' s'janë gjë tjetër veçse *Malësorët*, dhe *viset e (n)altinëve* janë *viset e malësorëve*.

Lidhur me vendodhjen e *Nikajve*, studiuesi i njohur sloven Franc Mikloshiq e thekson se fshati i vjetër *Nikajt* i Pultit shtrihet në territoret e *Nikajve* të sotëm¹¹.

Edhe studiuesit e njohur Selami Pulaha dhe Kolë Luka e mbështesin tezën e shtrirjes së *Nikajve* në këto troje, por ky i fundit ka një kundërtësi kur thotë se "Ardhja e *Nikajve* para 350 vjetëve, siç thotë gojëdhëna, nuk vërtetohet në bazë të dokumentacionit, sepse *Nikajt* janë aty të paktën qysh më 1335, dmth tash gjashtë shekuj e gjysëm, dhe me një vazhdimësi edhe më të plotë se Mërturi, të paktën qysh prej kësaj kohe e deri më sot"¹². E mendoj kundërtësi këtë, sepse unifikohen gabimisht përkimet e rastësishme të 'Nikajt' si toponim që nga 1335, me antroponimin 'Nika' si një i parë nga ku mori emrin fisi *Nikaj*. Një unifikim i tillë i fshatit *Nikajt* të Pultit para pushtimit osman, me *Nikën*,

të parin e *Nikajve* të sotëm, mendoj se është jokorrekt; ngjasimi i fjalëve është veçse i rastësishëm, siç e kanë theksuar dhe shumica e studiuesve.

Gjithashtu është i dokumentuar dhe një fshat i vogël *Nikaj*, në pjesën e juglindjes së zonës së Pultit¹³, por se në çfarë vendi saktësisht, burimi i këtij informacioni nuk e jep. Ndoshta është fjala për *Nicajt* e Shalës.

Si përfundim, duke marrë parasysh renditjen në listë të vitit 1485 të *Nikajt* në këto anë, ka arsye të mendojmë se *Nikajt* (ose *Nikita*) e rreth viteve 1330 përputhet me *Nikajt* e vitit 1485, si fshat diku në trojet e N-M, por pa lidhje me *Nikajt* e sotëm, pasi *Nika*, i pari i *Nikajve* s'kishte ardhur akoma në këto vise.

Mosdalja e *Nikajve* në defterin osman të vitit 1529-36 dhe mospërmendja e tij për një shekull, nga viti 1485 deri 1582, mund të fshehë dhe të vërtetën e vendbanimeve, vetë fatin e *Nikajve* të vjetër dhe daljen në skenë të *Nikajve* të rinj të sotëm. Dikur se ky vend në këto kohë ka përjetuar lëvizje popullore dhe shkatërrime të mëdha, pasi kemi *Vargun* dhe *Luzajën* ngjitur, të shkatërruar dhe të ripopulluar mëpas. (shih toponimin 'Vargu' dhe 'Luzaja')

Vendbanimi 'Nicagni' (ose Nikajt)

- Del në relacionet e priftërinjve misionarë qysh më 1628¹⁴ te Don Vincenti si *Nicagni* (Nikajni), vazhdon më 1671¹⁵ te Sh. Gaspari me 35 shtëpi dhe 300 frymë, më 1695-6¹⁶ te P. Orsigliada, më 1743 te Marko de Luki¹⁷ me 52 shtëpi dhe 472 banorë, pas 1745¹⁸ te Anonimi, më 1768¹⁹ te P. Onofrio, 1771²⁰ te Gj. Logoreci dhe më 1779 te L. Bardhi. Popullsia e këtyre viteve lëviz nga 300 frymë (1671) në 916 frymë më 1745 dhe 849 frymë më 1771.

Vendodhjen e fshatit 'Nicagni' tek relacioni i Sh. Gasparit të vitit 1671, studiuesi Ermanno Armao²¹ e lidh gabimisht

13 "Pilot u srednjem vijeku" (M. Gjukić), 1990 - "Stanovništvo slovenskog porijekla u Albaniji", Titograd, 1991.

14 "Relacion i Don Vincentit, sekretar i Ipeshkvit të Lezhës, mbi vizitën e Benedikt Orsinit nëpër malësinë e Shkodrës- Pult, 31 gusht 1628" - në veprën: "Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII - vëll. -I-rë (1610- 1634)" (përg. I. Zamputi), rel.29 (shkurt. 'D. Vincenti, 1628')

15 "Nji dorshkrim i vjetër 1671 mbi Shqipyni" - në rev.'H.Drites', 1930-1933; relacioni i Shtjefën Gasparit (Stefano Gaspari), Vizitator Apostolik, marrë nga drsh. që gjendet në "Biblioteca Nazionale" të Napolit (dosja VII.A.3-Brancaccio), shkurt. 'Gaspari, 1671'.

16 "Relacion i misionarit Padre Orsigliada, viti 1695-6"- nxjerrë nga vepra "L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande missionario italiano il P. Domenico Pasi S.I."(Fulvio Cordignano), vol.1,1933, (shkurt. 'P.Orsigliada, 1695-6')

17 Mark Palmikaj: "Pulti viti 743 - 10 Mars 2005", Prishtinë, 2017, f.30-31 - Ky është burimi për citimet nga relacioni i ipeshkvit Marko de Luki (Marcho de Luchi), 20 tetor 1743 (shkurt. 'Marko de Luki, 1743').

18 Dokumenta të pabotuem, Akti IV, në rev.'Hylli i Dritës', 1942, nr.11-12, f.391-403; përgaditur nga famullitari i Shalës At Rrok Gurashi. Këtij dokumenti do i referohemi si 'Anonimi, pas 1745', pasi i mungojnë fletët e para dhe të fundit të nënshkrimit, por bëhet fjalë për një relacion të imzot Aleksandër Bardhit [Alessandro Bianchi], të pas vitit 1745, sipas Rr.Gurashit.

19 Dokumenta të pabotuem, Akti LII, në rev.'H.Drites', 1942, nr.5-10, f.294-305; përgad.Rr.Gurashi. Relacion për Ipeshkvinë e Pultit, i vitit 1768, nga prifti misionar P. Onofrio di Bernalda, nën mbikqyrjen e ipeshkvit të Pultit Gjjon Logoreci (Giovanni Logorezzi), (shkurt. 'P.Onofrio,1768').

20 Dokumenta të pabotuem, Akti III, - rev.'H. Dritës', 1942, nr.5-10, f.305-311; përgad.Rr.Gurashi. Relacion për Ipeshkvinë e Pultit, i vitit 1771, nga Ipeshkvi i Pultit Gjjon Logoreci (shkurt. 'Gj.Logoreci,1771').

21 Ermanno Armao: "Vende, kisha, lumenj, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore", Tirane, 2006, f.155

1 Vlen të përmendet punimi i vitit 1977, i jashtëzakonshëm për kohën kur u shkruajt "Rreth toponimisë së trevës së Pjetërshpanëve...shek.XV-XVIII" (rev.'Stud. Filol.' nr.2,3, 1977), i studiuesit të njohur Kolë Luka, punim me të cilin jemi ballafaquar për të dhenat kryesore statistikore të fshatrave, duke i përballur me burimet e ndryshme dhe duke bërë shtjellimet tonë.

2 S.Pulaha: "Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485" vol.1, Tiranë 1974 (shkurt.'Def. Shkodr. 1485')

3 Defteri i Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1582 (AIH), nga "Başbakanlık Osmanlı Arşivi, Tapu Defterleri", Defteri nr.59, Defter-i Iskenderiye. (shkurt. 'Def. Shkodr. 1582')

4 F. Miclosich, "Monumenta Serbica", 1858, f.97 (cit. M.Gjukić-Pilot u srednjem vijeku, 1990 [Pulti në mesjetë])

5 Rr.Zojzi: "Tregu i Shkodrës dhe fillimet e industrisë së mëndafshit në vëndin tonë", në Bul.Sh.Sh. nr.1, 1954

6 E. Sufflay: Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters" (Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë, kryesisht në mesjetë), f.42

7 Konstantin J. Jireček: "Illyr.-Alban. Forschungen" (Hulumtime Iliro-Shqiptare), vol.1, f.113

8 V.M. Coronelli në hartën e v.1688 e shënon dhe kështjellën me këtë emër: "Letia, kështjellë me garnizon turkish", ku bëhet fjalë, sipas studiuesve, për kështjellën e Cernicës, e pozicionuar në fakt në qendër të Malësisë së Gjakovës.

9 At Bernardin Palaj, te 'Legjenda e fisevet', 1943, citon "...në Lug të Ltisë, siç i kanë pasë thanë Krasniqes motit..."

10 "Altin u XIV i XV veku"(Gordana Tomović), 1990

11 F. Miclosich, "Monumenta Serbica", 1858, f.97

12 Kolë Luka: "Rreth toponimisë së trevës së Pjetërshpanëve... (shek.XV-XVIII)", rev.Stud.Filol. nr.2,3, 1977, fq.cit.148 (nr.3, 1977).

me *Nicajt e Shalës* duke e “njëjtësuar me kishën e *Shna Prendes*” në Nicaj, nisur dhe nga pozicioni mbi Shalë i kësaj kishë (S. Veneranda) te harta e V. M. Coronel-lit. Renditja e fshatit *Nicagni* ‘6 milje larg nga Bjaka’ në relacionin e Gasparit, e hedh poshtë këtë njëjtësim të *Nicagni-t* me *Nicajt e Shalës*, pasi ky del i renditur me Gash, Bjakë e Palç, pra në viset e N-M. Përsa i përket kishës *Santa Veneranda* që ndodhet afër Nicajve të Shalës, nga e cila E. Armao bën lidhjen, kjo nuk qëndron sepse me emrin e pajtores Santa Veneranda (*Shna Prendja*) janë shumë kisha në gjithë viset e Pultit, si varg në brigjet e Drinit e lumenjve, dhe vetëm në zonën e N-M janë regjistruar mbi pesë të tilla²².

Gaspari thotë se Nikajt kanë dy kisha, të *Shën Gjon Pagëzorit* dhe *Shna Prëndes* (*Santa Veneranda*). Kisha e Shën Gjon Pagëzorit është kisha e vjetër në lagjen e Papelekajve të Epërm, mjaft e adhuruar nga fisi Nikaj. Pjetër Bogdani në një letër²³ të vitit 1676, na tregon sesi këmbana e bukur e kësaj kishë, me peshë 80 libra (rreth 60 kg, G.P.), u rrembye dhe u dërgua në Kullën e Sahatit në qytetin e Pejës. Kisha tjetër e Nikajve, ajo e *Shna Prëndes* mendoj se shtrihet në Ndërzhus, jo larg Vorreve të Trapeve (shih toponimin ‘Zhus’).

Sa i përket origjinës së fisit Nikaj, lidhja më e besueshme e Nikajve të sotëm me fisin Krasniqe është te vllaznimi Nik Mëkshi e Kolë Mëkshi, siç e thotë tradita por dhe gjithë studiuesit seriozë të kësaj fushe. Varianti tjetër i një vllaznimi të një *Nike*, *Krasi* dhe *Vaso*, edhe nëse është i vërtetë, mendoj se është i një kohe shumë më të hershme sesa brezat që lidhin Kolë Mëkshin me Nikë Mëkshin, dhe e ardhur si gojëdhënë e mjegullt, ka sjellë dhe ngatërresa në rrafshin sinkronik të përputhjes dhe nisjes së breznive nga një i parë.

Vetë fjala ‘*Krasniqe*’, me rrënjën e saj ‘*Krast*’ mesa duket ka një përmendje në toponimi shumë të vjetër, pasi në Krisobulën (diplomën) e Deçanit²⁴ të vitit 1330, gjëndet njëfarë ‘*Krastavljanë*’, e renditur në listë pas tetë fshatrave të kësaj ane, në krahinën e Altinit, dhe konkretisht renditja është: 1. *Trebopolje* (Tropoja), 2. *Babijane* (Babina), 3. *Luzane* (Luzha), 4. *Gorane* (? e papërcaktuar sot), 5. *Šipčane* (Shipshan), 6. *Sošane* (Shoshan), 7. *Bun-jane* (Bunjan), 8. *Greva* (? Grija) pranë Bujanit, 9. *Krastavljanë* (? Krasto, Hras-to, Krasniqe), 10. *Buljubi* (? sot i papërcaktuar). Gjithashtu ka një vendbanim ‘*Hrasto*’ te deferët osmanë të vitit 1485, 1529-36 dhe 1582, si dhe në relatorët kisharë qysh më 1628, te D. Vincenti, ku del ‘*Crastegnichieia*’.

Ardhja e Nikajve të sotëm është pas vitit 1550, dhe kjo është dhe koha më e arsyeshme nisur nga breznitë e fisit Nikaj (bur. F.Nopcsa, I. K. Malaj).

Tradita thotë se trojet e para të Nikajve kanë qënë në *Papelekaj të Epër*, ku është dhe kisha e vjetër me varrezat rreth saj²⁵.

Tek shtëpiat e para në afërsi të kishës dhe varrezave të vjetra, gjëndet dhe mikro-toponimi *Guri i Kalit*, një gur i ngritur si podium, mbi një shesh, ku gojëdhëna thotë se ai shërbente si platformë për të ndihmuar kapërcimin mbi kalë, nga i pari i Nikajve.

Por kur erdhën Nikajt e sotëm i gjetën të formësuara vendbanimet e hershme si *Vargu*, *Zhushi*, *Luzaja*, *Nikajni* i vjetër, *Kapiti*, *Pjaja e Mavriqit*, etj. Zgjerimi i vllaznive të fisit Nikaj në një territor dhe burime të kufizuara bëri që me “me hir a me pahir” të tjerët t’ja lëshonin vëndin, dhe ky largim i tyre ndodhi i shtrirë në kohë përgjatë dy shekujve. Vetë shtrirja e gjatë në kohë, e largimeve të banorëve të vjetër, jo me lidhje gjaku me dy fiset Nikaj e Mërtur, na lejon të kuptojmë se bashkëjetesa e tyre ka qënë paqësore në përgjithësi, “pasi të dy palët, të fisit dhe anas, ishin shqiptarë, me gjuhë, tradita e kulturë të përafërt” (D. Progni, vep. cit. Nikaj-Mërturi... f.47). Të gjitha fshatrat e reja të Nikajve, përjashtuar Kapitin, që u krijuan pas ikjes së banorëve të hershëm, morën emrat e kryeparëve të vllaznive të fisit, si Lekbibaj, Peraj, Gjonpepaj etj.

Nga pikpamja dioçezyane Nikajt si famulli më vete kanë dalë pas vitit 1775, me kishën e *Shën Sebastianit* (*Sh’Masjanit* në gjuhën vëndase) në Gjonpepaj. Objektet e vetme të shpëtuara nga zjarri shkatërrues i rënë në vitin 1993 në ish-kishën shkollë të Gjonpepajve, ishin vetëm dy gurë të gdhëndur si përkujtimore lavdërimi, si dhe kambana e kishës (pak e dëmtuar). Kambana ka qënë e prodhuar në Venecia më 1841 në një rënë nga fonderitë më të mira të Italisë, në “CANCIANI VENETI”, e cila furnizonte katedrale të njohura dhe kisha anëmbanë botës. Ndërsa njëri nga gurët e gdhëndur na kujton se kisha është rikonstruktuar më 1860, nën përkujdesjen e At Pal Berishës (Paulo Beriscia), i cili është shuguruar katër vjet më vonë, më 1864, si Ipeshkëv i Pultit.

Në territorin ku shtrihet sot fisi Nikaj, ka pasur rreth 16 kisha dhe kapela²⁶ të përmendura gjatë shekujve.

2. Mërtur - Del njëfarë *Martish* më 1485 (Def. Shkodr. 1485), por i vështirë si unifikim me Mërturin sipas S. Pulahës, me 7 zjarre dhe 500 akçe.

Del në relacionin e vitit 1628 të D. Vincentit si *Mortur*, afër Betucci (Bëtoshë?). Më 1768 te P. Onofrio, më 1771 te Gj. Logoreci, dhe më 1775²⁷ te Lek Bardhi. Këto janë të dhënat për Mërturin e krahut të djathtë të Drinit, pra në Nikaj-Mërturin e sotëm. Përgjatë shekujve XVII, XVIII, sipas relacioneve janë cituar përherë dy fshatra Mërtur: Mërturi këndeje dhe Mërturi matanë Drinit, ose Mërturi i Gurit, vëndi nga ku sipas gojëdhënës dolën mërturasit.

Fshati Mërtur këndeje Drinit, sipas traditës dhe sipas rrjeshtimit në relacionet e përmendura, është pikërisht fshati i sotëm Shëngjergj, i cili, duke u zgjeruar popullsia e fisit dhe duke u shpërndarë përrreth, s’mund ta mbante më emërtimin e vjetër *Mërtur* sepse u përkiste të gjithëve, por mori emrin e pajtimtarit të kishës së vet, pra *Shëngjergj*. Mërtur do të quhej

22 M. Palnikaj, Pulti..., f.94-104

23 Odette Marquet: “Pjetër Bogdani – Letra dhe Dokumente”, Shkoder, 1997, f.320; cit. M. Palnikaj, Pulti... f.102

24 “Dečanske hršovulje” (Miloš S. Milojević) -në “Glasnik srpskog učenog društva”, vol.12, Beograd, 1880, fq.27-38; (cit. “Altin u XIV i XV veku”-G. Tomović, 1990)

25 Dodë Progni, Zef Doda: “Nikaj - Mërturi. Vështrim historik”, Shkodër, 2003, f.43

26 M. Palnikaj, Pulti..., f.98-103

27 Dokumenta të pabotuem, Akti VII-IX, -rev. ‘H. Dritës’, 1943, nr.1-3, f.70-75; përgad. Rr. Gurashi. Relacion për Ipeshkvinë e Pultit, i vitit 1774, dhe 1775, nga Ipeshkvi i Pultit Lekë Bardhi (Alessandro Bianchi), shkurt. ‘L. Bardhi, 1774, ose... 1775’.

i gjithë fisi me lidhje gjaku, i cili kishte vetëdije se rridhte nga një i parë, duke pranuar dhe ata “anas” ose banorë që i gjetën aty kur erdhën, të cilët nuk ikën por ju bashkuan fisit. Kur pasardhësit e Lekë Pogut u zhvendosën nga Mërturi i Gurit rreth viteve 1500-1550, në Mërturin e sotëm djathtas Drinit, shumica e fshatrave që njohim sot ishin formuar tashmë, si Brisë, Salcë, Palç, Rajë, Ançit, Bjakë e Bëtoshë. Prandaj këto fshatra “...nuk morën emrin e kryeparëve të vllaznive të Mërturit por ruajtën emrin e vjetër që kishin. Vetëm Tetaj dhe Mulaj morën emrin e kryeparëve”²⁸.

Sipas një gojëdhëne, të rrëfyer në vitin 1962 (në kohën kur hartoheshin *Historikët e Fshatrave*) nga rapsodi Sokol Martini i Brisës (cilësuar si ‘*Homeri i Maleve Shqiptare*’), ai e çon dhe pesë breza më thellë sesa te Murr Dedi, numrin e breznive të fisit të Mërturit, dhe konkretisht: *Murr Dedi [Deti]*, 1. *Ded Hasani*, 2. *Hasan Jaha*, 3. *Jah Tagani*, 4. *Tagan Rexha*, 5. *Rexh Kuqi*, ‘prej Kuqit të Karadaktit’ (ose Malit të Zi, siç e quanin të vjetrit Malin e Zi nga turqishtja).

Edhe sikur ti supozojmë për të vërteta këto brezni, këtu ka një problem tek emrat. Po të ndjekim brezat e vllaznive të fisit të Mërturit²⁹ të gjithë bashkohen te Murr Dedi përpara rreth 13-15 brezash. Duke shtuar dhe pesë breza sipas gojëdhënës së mësipërme, zbresim në 20 breza në kohë, ose rreth viteve 1400-1450 (kjo n.q.s. një brez e llogarisim 30 vjet). Osmanët ishin futur në Ballkan në këtë kohë, por është e vështirë të besojmë që qysh në ato fillime, ai kishte arritur të ndikonte në vendosjen e emrave me patronimi turke (Hasan, Jahë, Tagan, Rexhë). Në gjurmë të kësaj gojëdhëne mund të kenë rënë dhe Baron Franc Nopça si dhe Edith Durham, kur e japin mundësinë e prejardhjes së fisit të Kuçit nga Berishajt (I. K. Malaj, vep. cit. ...f.393, burimi Nopça, Durham), pra lidhje dhe me Mërtur, pasi vetë “*Mërturi është Berishë*” siç citohet.

Lidhur me origjinën e emrit ‘*Mërtur*’ ka mendime të ndryshme, por të gjithë bien dakort në vjetërsinë e këtij patronimi të lashtë. E. Durham e çon shumë larg rrjedhën e emrit, që në kohërat romake, nga ‘*Merituri*’³⁰. Studiuesi At Zef Valentini, emrin ‘*Mertur*’ e sjell (me rezerva), se mund të rrjedhë dhe nga *Martusët e Drishtit*, kur shqyrton aspektin antroponimik të Dorëshkrimit të Pal Engjëllit³¹.

Nga pikpamja dioçezyane, në territorin ku shtrihet sot fisi i Mërturit në zonën N-M, ka pasur rreth 25 kisha e kapela (M. Palnikaj, Pulti..., f.94-104), disa shumë të bukura, të dokumentuara.

3. Brisë - Ka një dokumentim të hershëm, të paktën nga shek. XV e deri sot. Del më 1485 (Def. Shkodr. 1485) si *Brisa*, me 10 zjarre dhe 1000 akçe. Ka një rritje pothuajse dyfishë për gjysmë shekulli, nga 10 shkon në 18 zjarre, në vitin 1529-36³² (Def. Rumel. 1529-36) me emërtimin *Brisa*, dhe me 1600 akçe. Nga

28 D. Progni, Z. Doda: vep. cit. Nikaj - Mërturi..., f.56

29 Ibrahim Kadri Malaj: “Tropoja në breza – Monografi”, Tiranë, 2003, f.391-436

30 Edith Durham: “Brenge e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë e Shqiptarët”, Tiranë, 1990, f.447.

31 Giuseppe Valentini: “Il manoscritto ASHB 1167 della Laurenziana”, “Shpirti Shqiptar”, Torino, Viti I, nr. 3, 1955, fq.15-23; shqip nga italishtja: Willy Kamsi, rev. “Phoenix”, Shkodër, 1999, nr. 9/1

32 Defteri i timareve të Rumelisë i viteve 1529-1536 (AIH), nga “Başbakanlık Osmanlı Arşivi, Tapu Defterleri”, Defteri nr.367. (shkurt. ‘Def. Rumel. 1529-36’)

regjistrimi osman i vitit 1582 del si *Brica*, fshat kryengritës, si shumica e fshatrave të Pultit, dhe duke mos mundur të hyjnë që ti regjistrojnë si numër familjesh, zyrtarët u kanë caktuar vetëm detyrimet prej 2000 akçe, të dyfishuara për një shekull.

Del në shumë relacione të misionarëve. Fillon me atë të vitit 1628 si *Brisa* te D. Vincenti. Pastaj del pas një shekulli, rreth 1745, si *Briisa* (Anonimi). Më 1768 del te P. Onofrio, më 1771 te Gj. Logoreci, dhe me 1774 te Lekë Bardhi si *Brisa*.

Brisa ka pasur kishën e veçantë të Shënkollit (D. Progni, Nikaj-Mërturi... f.55), tashmë e rrënuar, me ndërtim karakteristik me gurë të hollë si rrasa, të lidhur me llaç, si të mureve ashtu dhe të qemerit të derës të harkuar, tipike kjo e një stili perëndimor romano-gotik ndërtimi. Sipas studiuesve daton qysh në mesjetë³³, dhe e ngjashme për nga ndërtimi i çatisë me kishën tjetër shumë të bukur të Toplanës, dhe ajo e Shënkollit si pajtor. Deri në vitin 1964 janë ruajtur muret e saj dhe dera e harkuar, por mëpas nuk i ka shpëtuar dot valës së shkatërrimeve të “revolucionit kulturor”. Ajo ka pasur gjithashtu një këmbanë me një tingull shumë të mirë, që siç thoshin të vjetrit “...është marrë te kumbonët e Zekut në Mal të Zi”.

Brisa është si vend kalimtar i dy rrugëve shumë të vjetra shtigje malore: njërës që vjen nga Toplana për në Brisë, Salcë, Palç, zbrit poshtë në Varg, kalon lumin dhe ngjitet për në Rajë; tjetra që vjen nga Shala ose Shoshi, Qafa e Agrit, Brisë, Salcë, Lekbibaj, Curraj i Poshtëm,

Qafa e Kolçit dhe vazhdim. Shtegu i parë ndjek pak a shumë itineraret e rrugës së vjetër që quhej *Drumi i Kaurrit* (shih mëposhtë).

Prejardhja e fjalës *Brisë* (ose *Bricë*), më mundësi ka që rrjell nga fjala *brinjë*, meqënëse vëndi është shpat, në brigje të Drinit, pra një oronim, ashtu siç e mbështet dhe E. Çabej këtë variant. K. Luka e mbështet trajtën *M-Bricë*, nga *brinjë*, pra si mundësi që rrjell nga një oronim.

Albanologu kroat Henrik Barić e sjell fjalën si të një burimi shumë të hershëm para- indo-europjan, mëpas tek thrako-ilirët, dhe ardhur sot si terminologji blegtorale, p.sh. në rumanisht kemi ‘*brinza*’ os “*djathë i deles*”³⁴.

Rreth prejardhjes së fjalës *Bricë*, sjellim dhe një variant të vitit 1962 rrëfyer po nga Sokol Martini i Brisës, ku thotë se kjo fjalë rrjedh nga emri i gurit të strallit, ose siç i thonë në këto anë ‘*bricë/a*’, = *gur stralli*; pasi në këtë vënd nxirrej ky gur. Kjo fjalë gjëndet dhe në “Fjalori i Gjuhës Shqipe”, 2006, A. SH. SH.-Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (fjala ‘*bricë*’ = *bricë/a f. sh. -a(t) gur stralli, strall*)

4. Salcë - Del e dokumentuar për herë të parë më 1485 me 8 zjarre dhe 400 akçe të ardhura (Def. Shkodr. 1485). Më 1529-36 (Def. Rumel. 1529-36) del *Salicë* me 10 zjarre dhe 1000 akçe. Tatimi është mbi dyfish, dhe pse zjarret janë shtuar shumë pak. Më 1582 kemi “*Salça*” me 2500 akçe të ardhura (Def. Shkodr. 1582), fshati i rebeluar.

33 D. Progni, B. Jubani –Harta Arkeologjike e Rrethit të Tropojës, gaz. ‘Shkëlzeni’, 1988

34 Henrik Barić: “Arhiv za arbanasku starinu” vol.1, 1923, f.142

Te relatorët kishtarë, më 1628 te D. Vincenti del si *Salza*. Emërtimi *Salza* (lexohet *Salça*, gj.femërore) e ndjek pastaj vazhdimisht. Më 1771 te Gj. Logoreci, jepen 54 shtepi me 614 frymë. Del pothuajse tek të gjithë hartat e vjetra. Kemi *Salza* (Coronelli, 1688³⁵) dhe te Cantelli (1689), por dhe *Salsa* (Coronelli, 1696³⁶).

Në lidhje me etimologjinë e fjalës, K. Luka bindet për oronim, nga një shënim i prof.E.Çabej kur thotë për *Gurzi-un* si “*tokë, salcë e bardhë*” (St. Fil. nr.1, 1966), si “*tokë mashkullore*”, jo shumë pjellore (cit.).

Unë po sjell një këndvështrim tjetër, nisur nga një dokument i vjetër, por që çon në të njëjtin përfundim të ngjashëm me dy profesorët e nderuar, mbi origjinën e fjalës nga një term orografik.

Një letër e vjetër, botuar në një revistë shkencore më 1730³⁷ dhe sjellë në shqip³⁸, e Kryepeshkvit të Tivarit Vincens Zmajević, që tregon për një burim uji të kripur diku në këto anë, na jep njëfarë lidhje për termin “*Salcë*” (ose *Salçë*). Burimi gjeologjik i ujit të kripur quhet “*fonte Salsa*” në italisht, siç është cituar dhe në dokument. Kripa që nxirret nga ky burim ishte “*perfekte dhe e bardhë*” (cit.).

Pra, mund të themi se një tokë “*salcë e bardhë*” (cituar nga E. Çabej) mund të ketë një lidhje me një tokë ku del një burim i ujit të kripur (ose “*fonte salsa*”, it.), dhe ku nxirret një kripë “*perfekte dhe e bardhë*”. Për këtë na ndihmon dhe homonimia gjuhësore mes “*Salsa*” si vendbanim dhe “*Salsa*” si burim kripe. Referuar Zmajevićit burimi i kripës ishte “*poshtë majës së malit të Shalës*”, pra jo larg Salcës së sotme. Nga hulumtimet e mija dhe nisur nga përshkrimi i vëndit sipas dokumentit, varianti më i mundshëm i vendodhjes së kësaj miniere të vjetër kripe është një gropë natyrore mes majave të thepisura mbi burimin e Lumit të Bardhë, sipër Vranës së Madhe të Nikajve. Këto maja janë kufi me Shalën dhe formojnë formacionin e majës së Shalës, aty ku dokumenti përcakton dhe vendodhjen e burimit të kripës. Varianti tjetër, më pak i mundshëm i kësaj miniere është maja e Ershellit mbi fshatin Salcë, pasi një nga formacionet e saj quhet “*maja e Shalës*”. Vlen të përmendet se vetë fjala “*Ershell*” (ose *Arshell*) ka të ngurtësuar në trup të saj fjalën “*shëlli*” pra kripë, “*Er(Ar)+shëlli*”. Por për përcaktimin e saktë se ku ka qënë kjo minierë kripe, duhet një studim i mirëfilltë nga gjeologë të fushës.

Ka dhe një fshat tjetër me emërtimin *Salca* mbi kodrat afër Ulqinit, të dokumentuar në hartat e vjetra si *Salza Villa* (E. Armao, vep. cit.... f.110)

5. Palç - Citohet tek të tre defterët e parë osmanë pas pushtimit. Më 1485 del si *Maleç*³⁹, por S. Pulaha e korrigjon më vonë si *Palçi*, me 5 zjarre dhe 500

35 V.M. Coronelli: “Corso delli Fiumi Drino, e Boiana nella Dalmatia”, Venetia, 1688. (hartë)

36 V.M. Coronelli: “Ristretto della Dalmazia”-në ‘Isolaro dell’Atlante Veneto’, Venetia, 1696. (hartë)

37 “Raccolta d’Opuscoli scientifici, e filologici”, Venetia 1730, vol.III, f.215-222.

38 “Burimi i mrekullueshëm i ujit të kripur në majën e Shalës dhe një relacion i panjohur i Imzot Vincenc Zmajević rreth vitit 1728”(G.Pecnikaj) – në rev.“H. Dritës”, nr.2, 2016, Shkodër; dhe gaz.“Koha Jonë”, dt.14.2.2017.

39 Ne nuk e dimë se sa i sigurt ka qënë S.Pulaha kur e ka korriguar leximin osmanisht nga *Maleç* në *Palçi*, por ka një mikrotoponim *Malezh* (pra të përafërt me leximin e parë) të ruajtur dhe sot si emërtim i një hapësire jo të madhe arash dhe gështenjash, në territorin e fshatit Lekbibaj.

akçe tatim. Del si *Puliç* më 1529-36 me katërfishim të zjarreve dhe të ardhurave (20 zjarre dhe 1600 akçe). Me 1582 me 3500 akçe, tatim shumë i rëndë, pa regjistruar zjarret sepse zona është kryengritëse. Shtatëfishimi i tatimeve për një shekull, na bën të mendojmë se fshati në shekullin e XVI-të do ketë pasur shtatëfishim shumë më të madhe se sot.

Në të gjitha relacionet e misionarëve del si *Palci*, më 1628 te D. Vincenti, më 1634 te Gjergj Bardhi⁴⁰ me 10 shtëpi dhe 83 frymë, më 1671 te Sh. Gaspari, më 1695-96 te Orsigliada, pas 1745 po *Palci*, gjithashtu dhe 1768 te P. Onofrio, 1775 te Lekë Bardhi.

Te kartografët del si *Palza* ose *Pulza* (ngjitur me *Salza*) pothuajse në të gjitha hartat mbi rajonin, të shek.XVII dhe XVIII-të.

Vëndi duket se ka një ekzistencë të vazhdueshme banimi përgjatë gjithë shekujve, dhe me përqëndrim jo të vogël, siç e tregon dhe toponimi ‘*Varoshi*’, ‘*Gjytetëza*’ ose ‘*Guri i Gjytetave*’, etj.

Etimologjia e emrit mund të ketë rrjedhë nga një antroponim *Pal* (ose *Palçi*).

6. Kotec: Ceket së pari më 1771 te GJ. Logoreci si dhe 1775 te Lekë Bardhi si *Ctezzi*, 50 shtëpi gjithsej me Brisë, Salcë e Palç që shkojnë me famullinë e Rajës. Koteci është i *Palçnuer*, pra të mëturas, të afërm me Palçin.

Origjina e emrit ka dy variante të mundshme: Nga tradita thuhet se ‘*i pari i këtij fshati quhej Kotel dhe ishte i Palçnuer*’ siç e sjell K. Luka. Varianti tjetër, por më pak i besueshëm, është nga vetë kuptimi i fjalës *kotec* në shqip.

Ngjitur me Kotecin është Vargu, qendër e rëndësishme në mesjetë dhe më herët.

7. Varg: Një ndër pesë qytezat e vjetra të Pultit. I pozicionuar mbi kodër, aty ku kryqëzohet lumi Drin me lumin e Mërturit, në të djathtë të tyre. E përmend si *Varcu* (Varku) për herë të parë D. Vincenti më 1628, një ‘*qytezë e shkatërruar, ish-seli ipeshkvnore e Pultit*’ (ndoshta Pultit të Epër, G. P.), me *manastirin e Shën Gjonit* të shkatërruar dhe pa njeri⁴¹. Më pas del dhe te Benedikt Orsini, një vit më vonë, më 1629⁴², po *Varcu*, qytezë dhe manastir i pabanuar, por manastirin e quan të *Shën Bartolomeut*. Frang Bardhi në relacionin e tij e quan dhe kishë *Katedrale të Shën Klementit*⁴³.

Aty ku fillon lagjja e sotme Varg, majtas rrugës, rreth 800 metra larg rrënojave të Vargut të vjetër, gjenden dhe rrënojat e kishës së *Shën Gjergjit* me varreza, të dukshme dhe sot mbi një kodër, shumë e vjetër, shkatërruar nga turqit.

Përmendja në relacione e emërtimeve kishë, manastir, katedrale, dhe veshja e tyre emrave të ndryshëm shenjtorësh pajtorë, si *Shën Gjoni*, *Shën Bartolomeu* apo *Shën Klementi*, na jep të kuptojmë se

40 I. Zamputi - “Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII – vëllimi-I-rë (1610-1634), Tirane 1963; relacioni nr.39, f.458-465: - ‘Relacion i Ipeshkvit të Sapës Gjergj Bardhit, mbi vizitën e kryeme në malet e Dukagjinit, të Pultit e të Kelmëndit, 1634’ (shkurt. ‘Gjergj Bardhi, 1634’).

41 I. Zamputi - “Relacione...- vëllimi -I-rë (1610-1634)”, rel. nr.29/ f.171

42 “Relacion i Ipeshkvit të Lezhës, Benedikt Orsinit drejtuar Kongr.Prop.Fide, mbi vizitën e bame në diocezin e Shkodrës, vjeti 1629” - në veprën: “Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore... - vëllim. -I-rë” (I. Zamputi), rel.30 (shkurt. ‘B. Orsini, 1629’)

43 “Relacion i Ip. të Sapës Frang Bardhit, drejtue Kongregat. Prop. Fide, mbi vizitën në Spas, Iballë e Pult...-qershor 1638” - nga libri “I. Zamputi - Relacione...-vëllimi -II-të (1634- 1650)”, Tirane 1965, rel. nr.30, fq.153.

kanë qënë disa të tilla, të cilat bashkë me godina të tjera ndihmëse dhe laike, formonin “bërthamën” e një qyteze jo pak të rëndësishme, pra një qytezë mesjetare ipeshkvnore, p.sh. si Drishti. Dhe gojëdhëna e jep “popullorçe” këtë përqëndrim ndërtesash, kur thotë se kanë qënë “*shtatë kishë në një kishë*”.

Në defterët osmanë del më 1529-36 si *Varaga* ose *Varga*, me 20 zjarre dhe 1300 akçe të ardhura. Më 1582 del si *Varka* me 600 akçe tatim. Këtu tregohet për vendbanimin i cili është ripopulluar me *ardhacakë*, pasi ka qënë shkatërruar përpara. Ka 4 familje të ardhurish, të krishterë. Këto kanë 157 akçe tatim.

Pas relatorëve misionarë të shekullit XVII-të, Vargun e eksploron në fillim të shekullit të XX-të dhe inxhinjeri austriak Karl Steinmetz më 1904 dhe 1905. Po ashtu e përmendin dhe F. Nopça më 1910 dhe konsulli austro-hungarez në Shkodër, Theodor Ippen.

Inxhinjeri austriak Karl Steinmetz sjell dëshmitë më të sakta. Më 1904⁴⁴, tregon se “...vetë misionari i Nikajve (prifti, G. P.) më dha mua një monedhë romake (*Sestercë*) të perandorit Marcus Aurelius, të cilën ai e kishte gjetur rrëzë mureve të ulëta rrënoja të Kishës së Vargut, rreth një orë larg në jug të Gjonpepajve.”⁴⁵, pra monedhë e shekullit të dytë pas Krishtit. I shtyrë nga interesi për këtë qytezë, ai i vizitoi përsëri rrënojat e Vargut, dhe më 1905 i botoi përshtypjet e tij në librin e rradhës⁴⁶, identifikoi rrënojat e vetë qytezës, duke e lidhur lashtësinë e saj me kohën romake, nisur kryesisht nga vjetërsia e mureve, tipologjia e ndërtimit dhe monedha e gjetur.

Vargun e kishin vlerësuar dhe studiues seriozë shqiptarë si p.sh. arkeologu Bep Jubani, i cili me shpresën se do ta eksploroonte “*për këtë qëllim, në shtator 1982, u gjend në Nikaj-Mërtur. Për fat të keq, Vargu, që i kishte shpëtuar përmblyjes nga ujërat e Lumit Drin, nuk kishte arritur t’i shpëtojë urdhërave të pushtetarëve të atëhershëm, të cilët në emër të ‘luftës kundër fesë’ dhe të hapjes së ‘tokave të reja’ pikërisht, mbi rrënojat e kishës së Vargut kishin urdhëruar ngritjen e disa objekteve social-kulturore. Me atë rast, qenë zhdukur edhe gjurmët e këtij qytetërimi të lashtë*”⁴⁷. Atë zhdukje që nuk e përmbyllën as kohërat e as pushtuesi, e përmbyllën shqiptarët ‘nën emrin e së resë’.

Populli i zonës, e ka glorifikuar shumë si një vënd të shenjtë, gojëdhanat janë të harlisura rreth saj: “...*kanë qënë shtatë kishë në një kishë*”, thonë të vjetrit. Sipas tyre, “*nga vëndi përtej Drinit, nga Apripa, shihej gjithmonë një thënë e lulëzuese mes pemëve dhe rrënojave të kishës, por kur i afroheshim rrënojave kurrë nuk e gjenim këtë pemë*”. “*Janë fshehtë kazana me päre të madhe nën dhe. Kërcisnin kazanat ndërmjet Shëngjergjave...*”. “*Janë gjetun kockat e këmbës së një njeriu sa të një kali, shumë të mëdha*”. “*I thonë ‘Kishë në një kishë’*”.

44 Karl Steinmetz (ing.) - “Eine Reise durch die Hochländergaue Oberalbanens”, 1904 [“*Një udhëtim përmes maleve të Shqipërisë së Epërme*”, K.Steinmetz]

45 K.Steinmetz, “Eine Reise...”, f.56-57: “...mir selbst übergab der Missionär von Nikaj einen abgenutzten Sesterz des Kaisers Marc Aurel, den er bei den niedrigen, mit Gestrüpp verwachsenen Mauerresten der Kiša Vargut, etwa eine Stunde südlich von Gjonpepaj, gefunden hatte.”

46 K.Steinmetz, - “Ein Vorstoz in die nordalbanischen Alpen”, 1905, f.44-46

47 D. Progni, Nikaj-Mërturi... f.14-15

sha e Vargut’ se njerëzit janë vënë varg për me transportue gurët për ndërtim, nga lumi Drin e deri nat’”.

Fakti se dokumentohet si qytezë, me gjurmë rreth 2000 vjeçare, dhe si qendër e rëndësishme kishtarë mesjetare, në një vend-kryqëzim lumenjsh, logjikisht na bën të kuptojmë se ai ka qënë dhe një vendkalim rrugësh të vjetra. Dhe në fakt flitet për një rrugë që ka ekzistuar dikur, e cila quhej në kohë të turkut “*Drumi i Kaurrit*”.

8. Rruga “Drumi i Kaurrit”: E përmend për herë të parë arkeologu i njohur britanik Sir Arthur Evans kur flet për arteriet e rrugëve të vjetra në veri të Shqipërisë. I bindur në ekzistencën e një rruge të vjetër më në veri sesa ajo e aksit Lezhë – Spas – Prizrenit, ai shkruan: - “...*Nga ana tjetër, tani kam marrë një sasi provash pozitive që tentojnë të tregojnë se rruga originale romake nëpër Alpet e Shqipërisë së Veriut u zhvillua në mënyrë të konsiderueshme në veri të rrugës të lidhur deri më tani me të (pra të rrugës Lezhë-Pukë, Vau i Spasit-Prizren, G.P.). Një miku im, që është dhe At Superior i Françeskanëve në Shkodër, më ka informuar mua për një pjesë të mirë rruge romake e gjërë dhe e drejtë, dhe pse tani është e mbuluar nga bari, që shtrihet përgjatë malit nga Dushmani në bregun verior të Drinit, disa orë në veri të Pukës, pastaj në Toplanë në luginën e Shalës, dhe kësh-tu me radhë në Brisë në zonën e Mërturit, afër Nikajve, nga e cila mund të kalohet mëpas për në në zonën e Krasniqes. Kjo është e njohur për shqiptarët si ‘Drumi i Kaurrit’, ose ‘Rruga e Gjaurit’ (Giaour’s Èay). Nuk ka dyshim se kjo shtrirje e mirë e rrugës romake përfaqëson një pjesë të linjës rrugore nga Lissus [Lezha, G.P.] në Ulpianë, dhe fakti se ajo përshkon përmes zonën e Krasniqes, na përgatit ne që ta kërkojmë daljen e saj më afër Gjakovës sesa Prizrenit*”⁴⁸.

Ashtu si A. Evans, dhe F. Nopça⁴⁹ e pohon ekzistencën e një rruge të vjetër në veri të Drinit që kalon nga Dushmani, Toplana, lugina e Shalës, Nikaj-Mërtur, lugina e Valbonës e më tej, por ai ka interpretimet e veta sa për gjurmët ku kalon dhe vjetërsinë e segmenteve të saj. Nopça thotë se një urë kalimi e Drinit që i përket kësaj rruge, ka qënë në vëndin që sot quhet *Shkallë (Scala)*, afër Mëshkallës së sotme, rreth 10km nga Vau i Dejës, në bregun e djathtë të Drinit, jo larg Komarnit⁵⁰. Këtu është dhe pika më e ngushtë mes dy anëve të shpateve të Drinit, ku mundësohej ndërtimi i një ure në këtë pjesë të lumit. Këtë rrugë e citon më 1918 dhe arkeologu hungarez Arpad Buday në botimin e hulumtimeve të tij arkeologjike mbi Shqipërinë.

E regjistruar në Nikaj në vitin 1956 nga Rrok Zojzi⁵¹, është dhe një gojëdhënë mjaft interesante që flet për këtë rrugë që kalonte nga qyteza e Vargut. Plaku i vjetër Deli Pjetra nga Lekbibaj i rrëfen etnologut: - “*Këtu...të gjithë jemë të ardhun...thuhet se këtu ka qënë kaurri. Kisha e Vargut nuk është e jona, e kemi gjetë. (Vijon në numrin e ardhshëm)*”

48 Sir Arthur Evans: “Antiquarian researches in Illyricum: Part III-IV”, 1885, fq.66-67

49 Franz Nopcsa: Aus Šala und Klementi, 1910, f.16

50 F.Nopcsa: Geographie und Geologie Nordalbanens, 1929, f.120

51 Rrok Zojzi: ‘Nikaj’, rev.“Kultura Popullore”, nr.1-2, 1993

KUR PARAJA TË ERRËSON SYTË

Nuk është rastësi, që kur identiteti e morali i shqiptarëve po venitet dhe demoralizohet. Drita në fund të tunelit shikohet shumë larg. Niveli i kriminalitetit i vështruar nga dinamika e intensiteti, llojet e përmasat e ditëve tepër të dhunshme e me pasoja të rënda. Grafiku në rritje i kriminalitetit kundër presonit, jetës e shëndetit. Vrasjet, trafiqet, emigrimi masiv i të rinjve. Mjedise të mbushur me fëmijë të cilët ose lypin ose përgatiten për të kaluar në morinë e kontingjenteve të hajdutëve ordiner. Të cilët janë bërë me dhjetëra të moshave të ndryshme, duke filluar nga fëmijët deri te moshat të tretë. Si rrjedhojë kemi qene dhe jemi përballë një pa siguri qytetare. Të gjitha këto konvergojnë në një pike të vetme e cila quhet para.

Paraja është e rëndësishme sepse është mjet jetese, por ka një kufi! Paraja nuk duhet të karakterizohet në idhuj. Me para mund të blesh gjithçka po asnjë here nuk mund të blesh lumturinë. Asnjë here para nuk mund të marrë më rëndësi se njeriu. Madje do të thosha, se është rrënjë e shumë të këqijave. Paraja mund të bëjë dike të lumtur, por nuk e ble dot lumturin. Të ndihesh i lumtur është një emocion, është diçka që e ndjen, jo diçka që e ble. Kjo është arsyeja sepse... Lumturia është shumë e shtrenjte. Ajo nuk blihet dot me para. Sipas filozofit antik Epikuri, tri gjërat që na bëjnë të lumtur janë: "1- Shoqëria, 2- Liria, 3- Reflektimi. Pra si për-

fundim thekson Epikuri paraja është e rëndësishme deri në nivel optimal. Pra deri në masën sa na mundëson të kemi miqësi, liri dhe jetë. Më tutje paraja është e padobishme" Fenomeni i kriminalitetit, ashtu si në gjithë vendin ka prekur edhe zonën e Dukagjinit. Edhe këtu krimet zanafillën e kanë te paraja. Zonë kjo e njohur historikisht për besë, burrëri, trimëri e humanizëm. Kjo zone ka qene dhe është shumë e varfër. Të varfër por të ndershëm. Asnjë here nuk ka pranuar që turpin ta hajë me bukë, mbase me bukë të pamjaftueshme për familjen. Por asnjë here nuk ka vuarë, nuk ka grabitur dhe nuk ka prerë asnjëri në besë. Ka jetuar në varfëri por me nderë e respekt. Ngjarjet e viteve e ditëve të fundit e kanë rënduar imazhin e mire të kësaj zone. Pra kanë ndodh vrasje, grabitje, vjellje etj. etj. Për trimërinë e humanizmin e Dukagjinave ka shkruar Franc Nopça në librin e tij. Fiset e Malësisë së Shqipërisë veriore dhe drejta zakone e tyre. "Një kryetarë fisi, duke zbritur rrugës për në Shkodër, takojë një grue, që qante, e pyeti se persë qante? Ajo ju përgjigje, se djali i saj i vetëm duhej atë ditë të luftonte me një negër, i madh sa Herkuli. I prekur nga dhimbja e gruas. Dukagjinasi e mori përsipër të luftonte në vend të djalit të saj. Propozimi u miratue në Shkodër. Pas dy luftimit, fitojë dukagjinasi. Çfarë se kur hyri në dy luftim, nuk i shkante në mëndë se

do të fitonte" Ky tregonte për humanizmin e dukagjinave. Po sot këto virtyte po veniten, po zbehen. Të gjithë duan të pasurohen pa djersë. Pra të bëhen me vila e makina luksoze, etja për para është bazë e të gjitha të këqijave, aq më tepër kur ajo është fituar me poshtërsi. Sa do para të kesh nuk mund të blesh disa gjëra. Me para mund të blesh librin, po jo dijen, mund të blesh ilaçe po jo shëndetin, mund të blesh postin, po jo respektin, mund të blesh femrën po jo dashurin. Prandaj paraja asnjëherë nuk të bënë të lumtur. A nuk tregojë tërmeti i datës 26.11.2019. Se dhënia pas fitimit arriti atje sa kompanitë ndërtoese të bëjnë ndërtime pa cilësi, jashtë çdo kushti e pasojat tani janë bërë të njohura. A nuk janë bërë këto ndërtime me lejen e shtetarëve, kundrejt ryshfeteve të majme?! Sa dëme njerëzore, sa dëme financiare, sa trauma e strese solli errësimi i syve nga paraja e këtyre oligarkëve, të cilët paranë e kanë perëndi të tjerat janë pa vlerë.

Detyrë prioritete e komplekse e krijimit të kushteve të frenimit të këtyre fenomeneve të ekstremizmit social të tyre. Duhet ti bëjmë të gjithë bashkë, duhet ta bëjë ligji, shteti, familja, edukimi, shkolla, media e shoqëria civile. Do veçoja më të rëndësishmet, Ligjin, shtetin e familjen. Komponent që duhet të harmonizohen, jo me fushata por në vazhdimësi sidomos nga organet ligj zbatuese. Le të kthe-

hemi 500 vjet më për para, te Kanuni i Lek Dukagjinit i cili tani ka mbete si relike e historisë. Për krimet të cilat u cilësuan më lartë. Sanksionet kanë qene të rënda, për ata që bënin krime të tilla. Lëçitja, djegia e shtëpisë, prerja e pemëve frutore, madje edhe rrëzimi i mureve të arave në tokat e fajtorit. Po tani?!?! Kam shumë shpresë te reforma në drejtësi se kriminelet nuk do livadhisin si në livadhin e tyre. Në jetën e përditshme, gjithnjë e më shumë po e shfrytëzojnë krimi i organizuar, kriminaliteti ordiner. I cili tani pa frikë mund të themi se po tenton të bëhet në mos shtresë, faktori i jetës sociale në shoqërinë tone. Pavarësisht shkaqeve që mund të rendisin për përhapjen e zgjeruar të krimin në shoqërinë tone. Unë besoj se më kryesori është se shoqërisë po i humbet kufiri që ndihmon të ndahet normalja nga patologjika. Për pasojë ndeshemi çdo ditë në shoqërinë tone me "luanët e krimin" që bredhin të lire dhe bëjnë gjëmën në familje e shoqëri. Të cilët janë bërë faktorë që determinojnë në realitetin makabër të krimin, i cili është faktorë më madhor që ka ndikuar në rënien e "çmimit të jetës" në shoqërinë tone. Të gjitha të këqijat, bëhen nga krimi i lidhur me ekonominë e si rrjedhojë dihet se është shprehje e koncentruar e politikës. Në rrënjën ose më mirë themi në themelet e saj qëndron paraja.

Përgatiti NDUE ZIÇI

ÇFARË "FSHIHET" PAS DITËS SË LINDJES?

Thëniet biblike

Nuk dihet me saktësi cila është origjina e festimeve për datën e lindjes apo e tortës që bëjmë për këtë rast.

Megjithatë, ajo që dihet është se kjo përmendet për herë të parë në shkrimet që vijnë nga Egjipti i lashtë (libri biblik "Gjeneza"), kur rreth viteve 3000 Para Krishtit festohej ditëlindja e një faraoni, shkruan gazeta "Huffinton Post".

Në dritën e këtyre dëshmimeve, epitologu James Hoffmeier mendon se kjo festë përputhet me shumë me datën e kurorëzimit të faraonit dhe jo me ditëlindjen.

Sipas tij, një ditë e tillë kishte domethënien e lindjes së tij si perëndi.

Qirinjtë mbi tortë

Ata që kanë vendosur për herë të parë qirinjtë mbi tortën e ditëlindjes janë grekët, të cilët ofronin ëmbëlsira në formë hëne me simbolin e perëndisë Artemis, në

shenjë përuljeje dhe falënderimi për këtë.

Për të ofruar imazhin e shkëlqimit dhe bukurisë së saj, grekët ndiznin qirinjtë dhe i vendosnin mbi këto ëmbëlsira. Ka gjasa që grekët t'i kenë huazuar festimet e ditëlindjes nga egjiptianët.

Romakët sjellin "risinë"

Romakët kanë qenë të parët që kanë festuar, njerëzit e thjeshtë më saktë, pasi grekët i organizonin këto festa veçse për perënditë.

Romakët festonin me familjarët dhe shoqërinë, duke i përfshirë këto madje në disa festime publike, sepse ditëlindja e njerëzve me influencë në shoqëri duhej të mbahej mend nga komuniteti.

Ata që festonin 50-vjetorin, merrnin një ëmbëlsirë të veçantë, të përbërë nga miell, vaj ulliri, mjaltë dhe djathë i bardhë.

Romakët kanë festuar vetëm mes

meshkujsh për një kohë shumë të gjatë, ndërsa femrat filluan ta festonin ditëlindjen e tyre rreth shekullit XII.

Një rit pagan në fillesa

Në fillim të shfaqjes së ditëlindjes, të krishterët e konsideruan një rit pagan.

Kisha i dënonte këto festime, pasi i gjykonte si një shenjë e keqe. Në shekullin IV, të krishterët ndryshuan mendim dhe filluan të festojnë lindjen e Krishtit.

Kisha e ka pranuar këtë festë edhe për të tërhequr ata, të cilët festonin Saturnaljet romake.

Kontributi i "revolucionit industrial"

Një periudhë kohe, festat e organizuara me rastin e ditëlindjes së dikujt përfshinin ëmbëlsira vetëm për të pasurit sepse përbërësit e tyre konsideroheshin produkte luksu.

Më pas, revolucioni industrial ka lejuar shpërndarjen e tyre tek të gjithë

njerëzit pjesëmarrës. Për më tepër, në fund të shekullit XIX, pastičeritë nisën të shërbejnë ëmbëlsira të realizuara në shkallë industriale me çmime të leverdishme për blerësit e tyre.

Kënga tradicionale

Jo të fundit nga rëndësia, në 1893, amerikanët Patty Hill dhe Mildred J. Hill shkruan një këngë, të cilën e titulluan "Mirëmëngjesi të gjithëve" (Good morning to all).

Kjo këngë duhej të këndohej nga nxënësit përpara nisjes së programit mësimor të ditës. Robert Coleman e përpunoi në 1924 duke i shtuar edhe disa vargje të tjera.

E kështu, kënga e re "Happy birthday to you" (Shumë urime për ty) u bë mjaft e famshme në të gjithë botën dhe shoqëron tashmë çdo festë ditëlindjeje.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja

Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:
HOTEL "BLINI"

